

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 185, Mars 2019

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## 7 MARS, DITA E MËSUESIT! 2

## 8 MARS, DITA E GRAVE, NËNAVE!

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me datën 5 mars 2019, në mjediset e Bar-Restorant "Orlando" zhvilloi takimin me mësues e mësuese dhe me disa gra e nëna dukagjinase, me rastin e 7 e 8 Marsit. Për 7 Marsin, foli mësuesi, studiuesi, poeti, publicisti e botuesi dhe anëtar i Këshillit të Shoqatës, z. Luigj Shyti, i cili në mes të tjerave theksoi: "Rastësia ka bërë që në Shqipëri festa e mësuesit dhe nënës, grave, 7 dhe 8 Marsi, të jenë kaq afër me njëra - tjetrën."



## VLERË NË SHTEPI!

Muzeu dioqezan ekspozoi me 9 Mars 2019, veprat e piktorit të famshëm Lin Delija, i cili gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë artistike dëshmoi energjikisht identitetin e prejardhjes. Kështu bëri të njohur përpara opinionit ndërkombëtar, vlerat, doket, kostumet dhe orientimet psikosociale të kombit në përfaqësim. Veprimtaria u organizua nga shoqata kulturore "Lin Delija Art" dhe Arqipeshkëvia Shkodër-Pult. Të prashmit ishin të shumtë, ndër të dhe personalitetet ...



5

## 70 vite hire dhe bekime në shërbim të dashurisë 13

**"ZOTI ËSHTË BARIU IM, ASGJË NUK MË MUNGON"**

*Kur jemi të veshur me Dashurinë e Zotit vërtet nuk na mungon asgjë. Dashuria e Zotit për **bijtë** e Tij është e pakufishme. Ajo na ofrohet në jetë në **forma** nga më të **ndryshme**. Na afrohet përmes **prindërve**, të afërmeve e te tjera.*

*Dashurinë dhe përkujdesjen Zoti e sjell ne jetën tonë edhe nëpërmjet Kishës, e cila merr jetë nga Provania Hyjnore dhe struktura saj **tokësore**. Ne, si grigjë e Zotit e kemi **gjithmonë të pranishme dashurinë, përkujdesjen dhe këshillën e Bariut tonë të Mirë, në rastin konkret të shkëlqesisë së tij Monsignor Angelo Massafres. Në këto ditë festë për Kishën, ne si grigjë e besuar në duart e tij me fjalë zemre i shprehim falënderimet ...***



## CURRAJ I EPËR VETËZBULOI VIRGJËRINË DHE HIRET E VETA RREZATUESE ALPINE 12

Nuk milet tambël ma i mirë prej cice se i deleve që kullosin bjeshkëve të Currajve, i cili nuk zihej pa ujë, ndërsa kosi pritej me thikë, si djathi i njomë. Edhe tlyni, kosi i kulluar, dhalla, mishovina ishin të mëlmyeshmet, të lehta, të lakmueshme dhe tregoheshin duke thënë: Ah, si tlyen, kos apo djathë Currajsh. Kudo në Dukagjin e më gjerë recitohej alegoria "Curraj të epër hanë kos të vjetër".

# 7 MARS, DITA E MËSUESIT! 8 MARS, DITA E GRAVE, NËNAVE!

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me datën 5 mars 2019, në mjediset e Bar-Restorant “Orlando” zhvilloi takimin me mësues e mësuese dhe me disa gra e nëna dukagjinase, me rastin e 7 e 8 Marsit.

Për 7 Marsin, foli mësuesi, studiuesi, poeti, publicisti e botuesi dhe anëtar i Këshillit të Shoqatës, z. Luigj Shyti, i cili në mes të tjerave theksoi: “Rastësia ka bërë që në Shqipëri festa e mësuesit dhe nënës, grave, 7 dhe 8 Marsi, të jenë kaq afër me njëra - tjetrën. Njerëzit që përfshihen në këto festa kanë në plan të parë edukimin e fëmijëve, të brezit të ri, të ardhmes së shoqërisë njerëzore. Shkolla dhe familja, veçanërisht nëna, gjitha jetën, madje edhe kur fëmijët janë rritur e janë bërë të zotët e vetit, përsëri nëna për asnjë moment nuk e largon vëmendjen nga ndikimi në edukimin e fëmijëve të saj. Këtë punë e bën edhe baba, por sot po flasim për ditën e gruas, nënës.

Të nderuar kolegë e kolege mësues të pranishëm!

Të nderuara motra të pranishme!

Jam i nderuar që kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, dhe kryetari i saj zoti Ndue Sanaj, më ka ngarkuar që në emër të saj t’ju përshëndes dhe t’ju uroj ngrohtësisht:

-Gëzuar 7 Marsin, festën e mësuesit të dashur mësues e mësuese!

-Gëzuar 8 Marsin, festën e nënës, gruas, motra të nderuara!

Këto festa nuk janë aspak për një grup të veçantë, një grup të vogël, por janë festa masive, nga më populloret që mund të jenë në Shqipëri, sepse nuk ka shtëpi pa fëmijë në një periudhë të jetës së saj, dhe një pjesë të madhe të jetës së fëmijëve të tyre e kalojnë me edukatorët, mësuesit, me mësuesit pra, dhe nuk ka shtëpi pa gra, sepse për ndryshe nuk ka asnjë kuptim, që është gjysma e më e mirë e popullsisë.

Festimi i sotëm është veçori, është një gjetje e kujdesshme e veprimtarëve të shoqatës dhe Kryesisë së saj. Për mua personalisht është nga më të bukurat takime e festime të këtyre dy datave shumë të rëndësishme gjatë jetës time jo të vogël në arsim.

Liria e lëvizjes, synimi për një vendbanim me më shumë mundësi për të ardhura ekonomike, më shumë kontakte shoqërore, më shumë zhvillim, më shumë shikim drejt zhvillimit e përparimit, drejt botës së qytetëruar, bëri të mundur lëvizjen e familjeve dukagjinase, siç pati lëvizje edhe në tërë Shqipërinë. Këtë e them me dhimbje të madhe, sepse u varfërua krahina jonë, iku rinia, mbetën shtëpitë më pleq e pensionistë, veç na rroftë telefoni për tu dëgjuar zërin. Këtu, përsëri të gjithë ata që kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në frontin e edukimit, nuk duhet ta harrojnë apo ta lëmë pas dore, që të paktën të mos humbin në vorbullat e jetës pa shënj e pa dokë të vëllezërve dhe motrave tona të cilët morën rrugët

e botës, të mos humbë, gjuha, historia, kultura e mirë, dashuria për prindërit, familjen, vendin amë, Shqipërinë tonë ta dashur. Koha mund të bëjnë të vetën, por sa të jenë e mundur të pengohet që të rezizojnë sa më gjatë. Prindërit, dhe në rastin konkret për sot, nëna, ka një rol dhe detyrë madhore në këtë drejtim.

Ruajtja dhe funksionimi i familjes edhe në kohë moderne është vlerë e qytetari, është kulturë, është domosdoshmëri në të mirë të kombit dhe emrit shqipëtar. Çdo komb ka të veçantat e tij, e këto të veçanta formojnë nacionalitetin e tij që është i ndryshëm nga të tjerët.

Të nderuar kolegë mësues!

Mësuesit dhe roli i tyre është, dhe do të jenë, në çdo kohë, faktor i pazëvendësueshëm dhe shumë i rëndësishëm. Arsimi është shtylla e kombit.

Nuk është e tepërt të thuhet se puna, qëndrimi dhe sjellja e mësuesit konsiderohet si njësi mase, si shembull, për të gjithë. Mësuesi është dhe duhet të jenë simbol i rregullit, pastërtisë, mënyrës së veshjes, sjelljes, tolerancës, të folurit e komunikimit të përgjithshëm, i sjelljes në shoqëri, etj.

Ne mësuesit, nuk mund dhe nuk duhet të harrojmë se nxënësit dhe prindërit e tyre, na dhanë emër dhe respekt, ndërsa ne, plot dashuri, u dhamë dhe duhet tu japim dije e kulturë për të ardhmen e tyre.

Të nderuar pjesëmarrës!

Duke përfunduar këtë përshëndetje ju uroj gëzuar dhe suksese motrave tonë në gjithë jetën e tyre personale dhe familjare, suksese kolegëve mësues, edukator të brezit të ri. Shëndet e jetëgjatësi të mësuesve pensionistë.

I lumtë Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” për këtë veprimtari shumë të bukur dhe domethënëse!

Për 8 Marsin foli kryetarja e seksionit të Gruas, Znj. Elida Delija, e cila në mes të tjerave theksoi: “8 Marsi, Dita Ndërkombëtare e Gruas. Një ditë shumë e rëndësishme kjo, në të cilën kujtohen arrijtet e kushteve sociale, politike dhe ekonomike të grave në botë, por edhe dhuna dhe abuzimi që shumë gra janë ende duke vuajtur.

Dita ndërkombëtare e gruas u shënuar fillimisht më 28 Shkurt 1909, në Shtetet e Bashkuara pas një deklarate nga Partia Socialiste e Amerikës. Ideja e të pasurit një ditë ndërkombëtare për gratë, ishte hedhur që në shekullin XX, në një botë, e cila po haste në industrializim të shpejtë, por një situatë e tillë çoi në protesta për kushtet e punës.

Në vitin 1910 Konferenca e parë ndërkombëtare e grave u mbajt, në Kopenhagen. Por kjo histori është edhe më e lashtë se kaq.

Fillimisht më 8 Mars 1875, në ndërmarrjen e tekstit në Nju-Jork, gratë u ngritën në protesta kundër kushteve çn-

rënë në një fabrikë ku punonin vetëm gra, në të cilën u shkaktuan 146 viktima, shumica e tyre emigrante.

Në Ditën e Gruas protestohet dhe festohet në shumë vende të botës. Në këtë ditë organizohen demonstrata dhe evenimente dedikuar grave. Kjo ditë shërben jo vetëm për bashkimin e grave pa dallim feje, race, kulture, gjuhe dhe prejardhjeje, por edhe për të kujtuar përpjekjet për barazi, paqe, drejtësi dhe ndërtim në gati 9 dekada. Për çdo 8 Mars fëmijët në të gjithë botën ju dhurojnë nënave të tyre lule e gjëra të tjera në Shenjë dashurie për nënën.

Kjo është historia në përgjithësi e kësaj date, 8 Marsit, ditës Ndërkombëtare të Grave. Ky takim, me rastin e 8 Marsit u vendos të organizohet nga kryesia e Shoqatës, së bashku me ditën e mësuesit, 7 Marsin, jo vetëm pse këto dy data janë afër njëra - tjetrës dhe duhet të bashkohemi e të kuvendojmë njëri me tjetrin, por dhe me qëllim që këto komponentë janë më të mundshmit për të bashkëpunuar në realizimin e mirërritjes, edukimit dhe marrjes dituri fëmijët tanë, djemtë e vajzat e bashkësisë Dukagjinase, në drejtim të emancipimit shoqëror.

Ju uroj punë të mbarë, jo vetëm në punën e pa ndalur në plotësimin plotësisht të drejtave tona, por dhe në detyrën tone të përhershme në edukimin dhe në emancipimin shoqëror të fëmijëve tanë!”

Pastaj përshëndeti, kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Z.Ndue Sanaj, i cili në mes të tjerave u ndal: “Kënaqësi, që në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe në emër të saj t’iu përshëndes ju

mësues e mësuese në këtë takim dhe gjithë mësuesit e mësueset kudo ata apo ato punojnë për mësimdhënie dhe edukimin e fëmijëve, me rastin e festes suaj, 7 Marsin!

Gëzuar!

Gjithashtu, kënaqësi t’iu përshëndes ju gra e nëna në këtë takim dhe gjithë grate e nënat kudo ata apo ato jetojnë e punojnë, me rastin e festes suaj, 8 Marsin!

Gëzuar!

Kryesia e Shoqatës, jo vetëm që e ka nderin t’iu takojë dhe të komunikojë me ju, në veçanti për punën e madhe e fisnike që bëni për rritjen e fëmijëve me normat qytetare, që ata të jenë të aftë për të dalë në jetë, si dhe për rolin e mësuesit e mësueset në dhënien e diturisë e edukimin e nxënësve e nxënëseve, për edukimi e fëmi-



Pamje nga mjedisi i Bar-Reastorant “ORLANDO”

jerëzore të punës, orarit të gjatë të punës dhe pagave të ulëta. Më pas në Kopenhagen u vendos të merreshin parasysh disa nga kërkesat e grave. Në mbledhje morën pjesë 100 gra nga 17 vende të botës, por nuk u vendos data, se kur duhej të kujtohej kjo ditë. Fillimisht kjo ditë manifestohet të dielën e fundit të muajt shkurt, por në vitin 1911, Danimarka, Gjermania, Zvicra dhe Austria, shënuan këtë ditë ku morën pjesë miliona burra dhe gra, ku veç kërkesave të mëparshme gratë kërkuan edhe të drejtën e votës.

Dita e Gruas u vendos fillimisht në përkujtim të demonstratës së grave punëtore në Nju Jork. Por përfundimisht, 8 Marsi u vendos si Dita Ndërkombëtare e Gruas, pas tragjedisë së 25 marsit 1911, në një fabrikë po në Nju Jork, ku zjarri i

# ZEF BARI, MËSUESI I PËRKUËSHTUAR DHE I VLERËSUAR PËR PUNËN E TIJ

Kushdo që e njih Zefin, ruan respekt për një njeri pozitiv, intelektual, i veçantë për batuta, duke lënë mbresa e dëshirë për ta takuar edhe më shpesh. I dashur me profesionin e tij të mësuesit, për të cilin ruan kujtime të pafundme dhe avokat i përhershëm për vendin e tij të lindjes, Thethin dhe thethjanët.

Ka punuar me përkushtim për 44 vjet, në frontin e mësimit dhe të edukimit, me shumë breza nxënësish, duke marrë kënaqësi, respekt dhe mirënjohje, për punën e tij, në këtë profesion, që ai e ka vlerësuar si mision me shumë rëndësi të jetës së vet: për të ardhmen e brezit të ri. Para pak kohe, Zefi ka filluar periudhën e pensionit, i vlerësuar dhe i plotësuar në çdo aspekt falë përkushtimit dhe kontributit të tij, në punë, familje e shoqëri.

Kur e pyetëm të na fliste për rrugëtimin e tij si mësues, ai fillon të tregojë me shumë pasion dhe dëshirë. Kjo sepse ai e ka kthyer mësimit në pasionin e jetës së tij: është bërë njësh me profesionin, i ka përkushtuar energjitë e jetës dhe ka marrë si shpërblim mirënjohjen e respektin e të gjithëve.

*“Kam qënë me fat që kam lindur në Theth, mes malesh dhe bjeshkësh. Jam rritë mes njerëzve të mrekullueshëm të atij fshati, njerëz me zemër të madhe e shpirt të pastër, që të falnin shumë dashuri dhe respekt, për të cilat unë kisha nevojë në hapat e mi të parë. Tjetër fat për mua ishte se mësuesit e mi në të dy ciklet, përveç se qenë nga qyteti i Shkodrës, ishin dhe shumë të kualifikuar e të përgaditur, si nga ana shkencore dhe pedagogjike. Mësuesi në atë kohë për nxënësin ishte gjithçka, i respektuar, personi më i vlerësuar në komunitet, më i veçanti, ishte më i dashuri e më i kulturuar, ishte pasqyra në të cilën secili prej nesh shikohej dhe shembulli që secili prej nesh donte të bëhej.*

Që në atë kohë, duke patur mësues

aq të vlerësuar, më imponuan që dëshira dhe pasioni im për këtë profesion do të realizohet. Pasi unë plotësova kriteret që kërkoheshin në atë kohë, kam filluar



shkollën Pedagogjike “Shejnaze Juka”, në shtator 1967 në Shkodër.

Emocionet e para si mësues i kam provuar para nxënësve në Kodër Shëngjergj në Lotaj, në Shtator të vitit 1973. Ata ishin nxënësit e mi, tani janë jo vetëm baballarë e nëna, por dhe gjysh e gjyshe të nderuar dhe të lumtur. Kam vazhduar të punoj në shkollat: Ndërlësë, Gag, Gimaj dhe Theth deri në fund të vitit 1996. Shkollat në atë kohë ishin vatra jo vetëm të dijës, por dhe të artit, të kulturës e të sportit. Mësuesi ishte me personalitet dhe integritet, i ndërgjegjshëm dhe i përkushtuar për misionin e tij fisnik dhe të rëndësishëm për edukimin e brezit të ri. Ishin vitet për të cilat unë ruaj kujtimet më të mira

të punës time si mësues, për angazhimin, rezultatet bashkëpunimin, jo vetëm në punën në shkollë, por dhe si veprimtar shoqëror, ose siç quhet tani punë në komunitet”.

Janë të shumtë ish nxënësit e tij, që e kujtojnë me respekt për punën e bërë nga mësues Zefi në klasë, por edhe për punën me grupet artistike, përgatitjet për shfaqje në festa dhe evente të ndryshme. Duke e pyetur Zefin se si vazhdoi pas vitit 1996, ai na tregon:

“Situata që u krijua pas ndërrimit të sistemit, lëvizja demografike që përfshiu zonat rurale drejt zonave urbane, për një jetë më të mirë, më detyroi edhe mua të largohem me familje nga Thethi në Tiranë. Sigurisht, vështësitë ishin të mëdha meqenëse unë në atë kohë kisha pesë fëmijë të vegjël. Kam emigruar ca kohë në Greqi, dhe pasi jam kthyer, kam filluar punë në shkollën 9-vjeçare “Niko Hoxha” në Valias në vitin 2001. Kam vazhduar deri në vitin 2012, dhe nga ky vit dhe deri kur dola në pension, kam punuar në shkollën 9-vjeçare “Demokracia” Valias i Ri.

Puna në këto dy shkolla ishte ekperiencë e veçantë: nxënës dhe mësues nga e gjithë Shqipëria, dialekte, zakone e tradita të ndryshme. Forma, metoda, struktura, reforma në organizimin e punës në shkollë dhe brenda orës së mësimit, shfaqjen ndryshime, krahas me ndryshimin e tërë sistemit. Këto shkolla qenë të mëdha, me klasa paralele, me vështësi në pamje të përgjithshme, por me staf pedagogjik të përkushtuar, me drejtues të aftë e bashkëpunues, bënë që puna të lehtësohej dhe rezultatet të jenë çdo vit në rritje. Këto cilësi, vlera e motivim, në veçanti i kam parë në shkollën ku unë dhe mbylla punën time si mësues”.

Një punë mjaft e madhe, me përkushtim, ku mësues Zefi ka shpalosur pasionin dhe profesionalizmin e tij, në drejtim

të tejçimit tek nxënësit të dijeve dhe të sjelljes, të orientimit në jetë dhe të nisjes mbarë të një rrugëtimi ku dija është mënyra më e mirë për tu përballur me jetën. Pra, gjatë gjithë jetës ka dhënë kontribut, po a ka marrë gjë në shpërblim? Vetë Zefi na totë:

“Ndjehem shumë i vlerësuar. Vlerësimin dhe respektin më të rëndësishëm për mua ma japin ish nxënësit e mi, që sot jetojnë e punojnë, jo vetëm në Shqipëri, por dhe jashtë saj, e në veçanti fëmijët e nxënësve të mi. Jam vlerësuar për punën time me dekorata, distinktive, certifikata mirënjohje, etj, nga të gjitha institucionet e arsimit dhe më gjerë. Rasti i festës së 7 Marsit të këtij viti, vlerësimi që mu bë, ishte nga shkolla ku kam punuar vitet e fundit dhe nga zyra arsimore Kamëz. Përveç, festimeve në shkollë, me kolektivin, me mësuesit e zonës dhe me miqtë, kishin organizuar edhe një takim dhe vlerësim nga ministrja e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve znj. Besa Shahini, që bën që të ndjehem mjaft mirë dhe i vlerësuar. Ndjehem i vlerësuar dhe i plotësuar edhe nga familja që më krijojnë një mjedis familjar të ngrohtë dhe një siguri që vitet e pleqërirë të mos më trembin. Ndjej se akoma kam për të dhënë dhe akoma jam i dobishëm për vete, familjen dhe shoqërinë, sigurisht me një ngarkesë ndryshe, por që do të ketë vazhdimësi”.

Jam shumë i bindur që të vazhdojë të jetë shumë aktiv: si në kontributin e tij në angazhimet shoqërore, ashtu edhe në pasqyrimin e eksperiencës së tij në vite. Të gjithë ne, së shpejti do të kemi në duar librin e parë, që do të shoqërohet edhe me të tjerë, ku pasqyrohet krijimtaria e tij, por edhe trashëgimia shpirtërore dhe krijimtaria popullore e zonës prej nga vjen.

Urojmë që mësues Zefi të kalojë pleqëri të mbarë, të shëndetëshme, prodhuese në krijimtari e në botime dhe të lumtur!

**Zef Gjeta**

jeve, që ata apo ato të emancipohen me normat qytetare.

*Konferenca e VI të Shoqatës, që zhvilloi punimet e saj, me datën 21 tetor 2018, në mes të tjerave vendosi të ndryshojë misionin e saj, i cili ishte: “Duke u mbështetur në historikun e së kaluarës dhe të sotmes, duke respektuar ndjenjat dhe sakrificat e të parëve për liri e pavarësi, Dukagjini të zërë më mirë vendin që meriton në Botën e qytetëruar e modern” dhe Shoqata në të ardhmen të punojë me Misionin, “Puna dhe përpjekjet që duhen bërë, krahas vijimit të njohjes së mëtejshme e promovimit të vlerave të zonës së Dukagjinit, për emancipimin shoqëror të dukagjinave kudo janë, me objektivin që si qytetar të mirë e në bashkëpunim me njeri - tjetrin, të ecim përpara drejt standardeve evropiane”.*

*Për të realizuar këtë mision të shoqatës, roli i nënës dhe i mësuesit është i padiskutueshëm. Kryesia e Shoqatës do të bëjë përpjekjet e saj, që nëpërmjet medias të shkruar e asaj televizive, nëpërmjet*

*jet veprimtarive të ndryshme, nëpërmjet takimeve e vizitave në mjedise edukative, por rolin tuaj nuk mund ta zëvendësojë. Prandaj, në të ardhmen do të bëjë përpjekje për t’iu takuar më shpesh, për të tërhequr mendime, për të stimuluar nxënësit më të mirë, për të përgatitë orë letrare me nxënësit krijues, për të hapur ekspozita pikturë e veprimtari të tjera me talentet përkatëse.*

*Për këtë qëllim, Këshilli i Shoqatës miratoi ngritjen e seksionit për marrëdhëniet me shkollat, që kryetar i tij është mësues Arbër Shytani dhe seksionin e gruas, që kryetare e tij është zonja Elida Delija.*

*Kam besimin, se më mirë do të ecim në të ardhmen për një bashkëpunim sa më efektiv, në shërbim të realizimit të misionit tuaj, për realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini””.*

Pastaj, u komunikua vendimi i kryesisë, që, me rastin e këtyre dy festave, me propozim të seksionit të shkollave dhe të seksionit të gruas, vendosi të nderoj me

titull nderi “Mirënjoha e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, disa mësues e mësues si dhe disa gra - nëna, si më poshtë:

*Së pari, në fushën e shkollimit, ju është dhënë ky titull 13 mësuesve e mësueseve: Familjes Gjokë Pjeter Marku, familje arsimtarësh, e cila me rastin e Konferencës shkencore për shkollimin e 100 viteve, në Dukagjin, i është propozuar Presidentit të Republikës për dekorim; Gjok Verrishta, Jak Sharani, Drande Kole Odri, Leke Pjetri, Gjyste Lera, Gjergj Shytani, Prenda Sogja, Simon Zhuri, Violeta Plepi, Lazer Filipi, Lule Ahi dhe Muç Marku.;*

*Së dyti, 18 grave ju është dhënë ky titull: Age Gila, Tone Pal Cuni, Age Tome Rroku, Shaqe Ndoja, Violeta Verrishta, Sose Bari, Prenda Dede Cardaku, Dukate Bregu, Moter Dukate Radoja, Lule Gjon Molla, Moter Leze Preka, pas vdekjes, Katrina Fusha, Leze Bungaja, Drande Dema, Lula Ndoja, Mri Vogel Pjetri. Ndërsa N/Kolonele Tringa Rapi, është nderuar me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini” dhe Gerta Bardeli*

është nderuar me titullin “Anëtare Nderi e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”.

Pastaj u kalua në një koktej, të përgatitur me shumë bujari nga Tome Arra!

Për këtë veprimtari punoi Roza Pjetri, Luigj Shyti, Elida Delija, Age Martini e Prele Shytani, të cilët i falënderojmë për ndihmësen që dhanë.

Për përgatitjen e zhvillimin e kësaj veprimtarie ndihmuan financiarisht:

Pronari i Bar –Restorant “Orlando”, Tom Arra, i cili na siguroi sallën, fonine dhe një koktej të mirë;

Edmond Tërthorja, administrator i Universitetit Bujqësor në Kamzë;

Gjergj Leqejza, konsulli i Nderit i republikës së Austrisë në Shkodër e N/Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”;

Shkrimtari Ndre Guri dhe avokati Tonin Marku.

Të gjithë, në emrin e shoqatës i falënderojmë dhe ju urojmë, me shprehjen popullore: “Paçin e dhënçin!”

**Redaksia**

# NDAHET NGA JETA INTELEKTUALI SHPËTIM LAME

Në ditë të vështira të vinë në mëndje thënie, që të bëjnë që të durosh dhimbjen dhe të gjesh ngushëllim. Një nga këto është edhe thënia e Platonit se “Jeta nuk është e drejtë, thjeshtë duhet të mësohemi me padrejtësitë e saj”.

Zgjedha thënien e filozofit të madh, Platonit, pikërisht në këtë ditë pikëllimi të ikjes nga kjo jetë të një personi të dashur, do të shkruante kushriri i tij, Skënder Lazaj.

Shpëtimi ishte një intelektual i denjë, ishte patriot i devotshëm dhe një familjar shumë i mirë.

Me të mbaruar shkollën, Shpëtimi emërohet mësues fizike në Gimaj-Shalë dhe pas disa vitesh emërohet drejtor i shkollës së mesme në Breglumi-Shalë. Për vitet e punës në Dukagjin, si edhe shumë të tjerë, pati gjithnjë nostalgji dhe respekt të përhershëm për malësorët e këtyre anëve, për nxënësit e shkollës, për punën mësimore dhe edukative, për gjithë jetën në ato vite të vështira, por të bukura.

Me largimin nga Dukagjini, punon në drejtimin e shkollave të ndryshme në qytetin e Shkodrës, me përkushtim dhe kompetencë profesionale. Kishin nevojë për punën dhe mendjen e Shpëtim, prandaj në vitin 1997 e emëruan drejtor të Drejtorisë Arsimore në Shkodër. Por pa kaluar shumë, menjëherë pas luftës së Kosovës, e emëruan si diplomat pikërisht në vitet më të vështira në Kosovë ku dhe jetoj dhe punoi për 18 vite duke fituar respektin e politikës dhe të intelektualëve vendor si një person këmbëngulës me intelekt dhe integritet të lartë, si një bashkëkombas model dhe i përkushtuar në çështjen shqiptare. Nuk hezitoi kur koha e thirri në detyra të tjera sa të larta po

aq edhe problematike, të cilat i përmbushi me sukses. Por as karakteri i çeliktë, as shpirti i tij luftarak dhe as mosha relativisht e re, nuk e shmangen përballjen,



dyluftimin dhe dorëzimin me sëmundjen e pamëshirshme.

Që në ditët e para që kontaktova me Shpëtim Lamen u bëmë miq si vëllezër për së vërteti. Që në ditën e parë, gjetëm gjuhën e përbashkët, se nuk mund të ishte ndryshe me Shkodranin e arsimit e kulturës si ishte Shpëtimi, do të shkruante Fetah Bakija nga Gjakova, i cili banon në Prishtinë.

Shpëtimi dha një ndihmesë të vyer që Kosova të tejkalonte situatën e vështirë pas lufte. Bashkë me zotin Fetah Bakija bënë të mundur që të fillonin marrëdhëniet me UNMIK duke nënshkruar marrëveshje

Unë e ëndërroj Ditën e 8 Marsit duke u bërë e zakonshme sepse të drejtat e grave do të ishin të paktën të barabarta me ato të burrave. Kjo, parë nga një këndvështrim i përgjithshëm por në një spektër më të ngushtë do të doja gjithashtu të shihja marshimet e krenarisë së grave që vuajnë nga probleme ekonomike, të grave që janë të burgosura e që kanë braktisur fëmijët e tyre, të grave që janë të pa mbështetura, të grave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor- e të tjera grave që zëri i tyre është i heshtur për të festuar gjithandej me kostume imagjinare. Por ne kemi nevojë për të dyja të drejtat e grave dhe të grupeve të marginalizuara njëkohësisht, të drejtat tani sepse lufta për të qenë thjeshtë e zakonshme, një fakt i jetës, është larg nga fitorja

Sot, ne duhet të mbajmë dhe festojmë ditë të veçanta, me marshime dhe slogane, për të mbajtur në dritë padrejtësinë. Le të mendojmë për një moment “Një botë pa gruan”. Në mendjen e secilit mund të kalojnë mendime të ndryshme... por megjithëkëtë gjinia femërore, duhet të respektohet në të gjitha fushat e jetës thjesht për faktin se është “femër”, për faktin sepse është njeri me të njëjtin dinjitet dhe meriton të drejta të njëjta si çdo

njeri shpejt pas lufte.

Gjatë punës në Kosovë u dallua si analist i situatës politike, veçanërisht për Kosovën. Ai e deshi me shpirtë Kosovën.

Punoi në Kosovë për 18 vite dhe la emrin e mirë dhe punën rezultative shembullore. Fetah Bakija e kujton me shumë respekt Shpëtim Lamen si njeri i ndershëm, parimor, më përgjegjës të lartë për detyrat e ngarkuara, i pa kompromis ndaj çdo parregullësie në punën që drejtonte. Rrallë më ka ndodhë të takoj njerëz me virtyte të larta njerëzore si të Shpëtim.

Njeriu e zgjedhë mikun, por edhe vëllain, atëherë unë të zgjedha që në fillim ty Shpëtim Lame, shkruan Fetah Bakija.

Shpëtim Lame u përcoll për në banesën e fundit me nderime dhe respekt, nga familja e tij e mirë, të afërmit, shokë e miq të shumtë nga qyeti i Shkodrës dhe malësorë dukagjinas, ish nxënës dhe kolegë mësues, politikanë e dashamirë të

shumtë. Për ta përcjellur për në banesën e fundit kishin ardhur edhe shumë miq të tij nga Kosova, si Fetah Bakia me djalin dhe vajzën e tij, sepse e njohën në kohë të vështira për Kosovën, u bënë miq të mirë e mbetën miq për gjithmonë, por edhe shumë të tjerë nga krahina të tjera të Kosovës.

Ai do të kujtohet me respekt nga ish nxënësit dhe kolegët e tij në Gimaj të Shalës, në shkollën e mesme në Breglumi të Shalës dhe në të gjitha shkollat ku punoi, për përgatitjen e tij të lartë shkencore dhe pedagogjike, për komunikimin më nxënësit dhe prindërit e tyre. Ishte shem-

njeri tjetër.

Si qytetarë të vetëdijshëm, ne, femrat, e dimë se bota po kalon nëpër një fazë krizash, por ne nuk pranojmë të jemi viktimat e saj. Ne përbëjmë më shumë se gjysmën e popullsisë së botës dhe ne e dimë se fuqia e qëndrueshme është me ne. Të mbahet parasysh se në vendimin tonë varet nëse jeta në Tokë do të vazhdojë. Parë nga kjo perspektivë, më e rëndësishmja, është një gjest i tërheqjes nga një prodhim kapitalist patriarkal dhe riprodhim social; një gjest potencialisht ngjites që rezonon përtej thirrjeve të thjeshta për njohje dhe mbrojtje nga ana e Shtetit.

Më lejoni të përfundoj tani një ikje të shkurtër në të ardhmen. Unë shpresoj se është e qartë tani pse unë do të kem mirëpritur obsoleshencën e çdo festimi të veçantë të 8 marsit, përveç nëse ajo është në kujtesë të ... kaq shumë përpjekjeve, kaq shumë betejave. Preferoj të besoj se gratë do të sjellin shumë ndryshime sociale, kulturore, ekonomike dhe ligjore. Se në të gjithë botën, ata mund të jenë luftëtare dhe se burrat, shumica e njerëzve do të luftojnë me ta. Më pëlqen të mendoj se policia, gjykatat, ligjvënësit, të gjitha autoritetet dhe shoqëria në përgjithësi do të konsiderojnë çdo çështje

bull në drejtimin e shkollës duke menjanuar tutelën, duke ndihmuar mësuesit si në pikpamjen metodike, por edhe shkencore. Ishte njeri me iniciativë, këmbëngulës dhe vizionar. Përpiqej me të gjitha mënyrat për drejtësi e zbatimin e ligjit duke bërë të mundur sqarimin e çështjeve në mënyrën më të mirë të mundshme.

Shpëtim Lame do të kujtohet me respekt, shumë gjatë, për punën e tij kudo që punoi e jetoj, në qytet apo në fshat. Respekt e kujtesë të veçantë do të kenë nga ata mësues që lëvizën nga zonat e thella dhe u vendosën e qytet apo zonat fushore edhe për mbështetjen e që gjetën te Shpëtimi, të cilët lëvizën vrullshëm nga zonat malore, e që kërkonin punë në këtë sektor pas vendosjes në qytet apo në zonat fushore. Shpëtim Lame bëri gjithë sa ishte e mundur, pa u kursyer, për sistemimin e tyre në punë, e kjo ishte si një respekt që ai kishte fituar gjatë punës së tij të gjatë në Dukagjin, për malësorët e këtyre anëve.

Familja humbi njeriun e dashur, shoqëria një mik të mrekullueshem dhe vendi një mendje intelektuale.

Për punën e mirë të bërë në shërbim të arsimit dhe kulturës në Dukagjin, dhe më tej, Shoqata Atdhetare “Dukagjini” e ka nderuar me titullin “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin”, me rastin e qind vjetëve të arsimit shqip në Dukagjin.

Shpëtimi la pas bashkëshorten, Leonora dhe dy vajzat e tyre, për të cilat uroj që të gjejnë forca për të përballuar këtë humbje të madhe dhe të parakohshme.

Të qoftë i lehtë dheu që të mban o Shpëtim Lame.

Nga **Luigj SHYTI**  
13 mars 2019

## A ËSHTË ENDE E VEÇANTË TË FESTOJMË 8 MARSIN?

Përshëndetje të gjithëve! Po e nis këtë artikull me një pyetje “A është akoma e veçantë të festojmë 8 Marsin?”

Le të kujtojmë së pari se jo të gjithë theksojnë se titulli zyrtar i kësaj dite është Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Grave. Shpesh harrohet se dita ndërkombëtare e 8 marsit e grave filloi me punëtorë të fabrikës së femrave. Greva, ndalimi i punës së grave qëndron në origjinën e saj dhe jo protestat e dëgjueshme ose festimet e të drejtave të fituara që më vonë do të shënonin rastin. Për të vijuar, gratë kudo duhet të kenë të njëjtat të drejta si gjinia mashkullore. Të dyja gjinitë duhet të pranojnë se lufta për të drejtat nuk është fundi dhe se ata që kanë fituar mund të zhduken në mënyrë të shkurtër, kur vigjilenca të lëkundet.

që u përket grave po aq me seriozitet sa të gjitha çështjet e tjera në librat e statutit dhe se asnjë grua kurrë nuk do të jetë e ekspozuar ndaj retorikës, talljes apo frikës, sepse ajo kërkon drejtësi. Dua të besoj se gratë që sot jetojnë në kultura që kërkojnë nënshtrimin e tyre do të fitojnë lirinë e tyre.

Le të festojmë 8 marsin si një ditë që shënon përparim të konsiderueshem këtë vit, por gjithashtu si një ditë e veçantë e destinuar të zhduket sepse gjinia femërore do të vazhdojë të jetë e tashmja në çdo moment të jetës, derisa të arrijmë barazi, respekt dhe dinjitet të vërtetë.

E ardhmja është emocionuese. Le të ndërtojmë një botë të balancuar gjinore.

Gjithkush ka një pjesë për të luajtur - gjatë gjithë kohës, kudo.

Nga aktivizmi bazë në veprim në mbarë botën, po hyjmë në një periudhë emocionuese historike ku bota pret bilancin. Ne vërejmë mungesën e tij dhe festojmë praninë e tij.

Bilanci drejton një botë më të mirë pune.

Le të ndihmojmë të gjithë për të krijuar një #Balanc për më Mirë!

Nga **Suela Ndoja**

# 21 MARS, DITA BOTËRORE E POEZISË

Që prej vitit 1505 Dita e Poezisë ka qenë e pranishme për të gjithë ata që e duan pranë. Por UNESCO në vitin 1999 më 21 Mars ndërmori një iniciativë për t'i dhënë gjallëri, vlerësim dhe shtysë lëvizjeve poetike kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Vendimi i marrë në Kongresin e 30-të të kësaj agjencie, zhvilluar në Paris, ka si objektiv kryesor mbështetjen e diversitetit lingvistik përmes shprehjes poetike. Në të njëjtën kohë, caktimi i një dite ndërkombëtare për poezinë bëhet edhe me qëllimin për ti kthyer kësaj gjinie të letërsisë funksionin e saj të parë, traditën gojore. Në Greqi poemat e Homerit mësoheshin përmendësh dhe recitoheshin kryesisht në ambiente publike. Në këtë mënyrë UNESCO kërkon që përmes recitaleve të ndryshme, përmes takimeve poetike dhe mbrëmjeve artistike të krijojë një urë lidhëse mes poezisë dhe formave të tjera të artit. Para caktimit të 21 marsit, si dita botërore e poezisë, ishte 15 tetori që kremtohej në të gjithë botën, pasi ai përkonte me ditëlindjen e poetit epik romak, Virgjil. Në disa vende kjo traditë e të festuarit në muajin tetor vazhdon të ruhet ende. Megjithatë shumë prej nesh e pëlqejnë poezinë, ose më mirë parapëlqejnë ta përdorin atë sidomos në komunikimin me personin e zemrës, poezia në ditët tona nuk lexohet më aq shumë sa vite më parë. Poezia "Në mundësh", ndryshe e quajtur *psalm i shenjtë i vullnetit*, qarkullon ende për të mbetur përjetësisht në kujtesën e gjeneratave si një shkrepim të vezullim të drite.

## NË MUNDËSH

(Rudyard Kipling -1907)

Në mundësh të ruash arsyen kur bota humbet fillin e fajin ty ta hedh dhe vehtes t'i besosh, sa herë të ty dyshojnë e s'të përfillin,


But make allowance for their doubting too;  
If you can wait and not be tired by waiting,  
Or being lied about, don't deal in lies,  
Or being hated, don't give way to hating,  
And yet don't look too good, nor talk too wise:  
  
If you can dream—and not make dreams your master;  
If you can think—and not make thoughts your aim;  
If you can meet with Triumph and Disaster  
And treat those two impostors just the same;  
If you can bear to hear the truth you've spoken  
Twisted by knaves to make a trap for fools,  
Or watch the things you gave your life to, broken,  
And stoop and build 'em up with worn-out tools:

por edhe dyshimet drejtë t'i gjykos....  
Në mundësh të rrih në pritje nga pritja pa u lodhur,  
a kur t'urrejnë urrejtje mos t'ushqesh,  
madje ndaj shpifjeve të rrih pa folur,  
me thjeshtësi me to pa rënë ndesh.....  
Në mundësh t'mendosh por jo gjer në shkatërrim,  
t'ëndërrosh, por jo si rob ëndërrimesh.  
dhe ti t'i trajtosh një lloj e pa dallim,  
ngadhnjimin e shpartallimin, burim mashtrimesh....  
në durosh dot që thënjt e tua të drejta  
në kurthe trutharët kopukët të t'i kthejnë,  
t'i shohësh të thyera gjërat me të shtrenjta  
e prap t'i ndërtosh me vegla që nuk vlejnë  
Në mundësh fitoret që ke korrur t'i flijosh,  
si në kumar me një të vetme lojë,  
të rrezikosh e prap t'ja fillosh dhe

humbjen kurrë të mos e zësh me gojë.....  
Në i detyrosh dot muskul, nerv dhe puls e zemër,  
të të shërbejnë edhe kur gjithçka duket e kotë.  
e të qëndrosh kur s'ke asgjë veç vullnetit,  
që veç një fjalë "qëndro" gjithnjë të thotë...  
Në mundësh të flasësh me maskarenj, por nderin tënd të ruash  
a t'ecësh përkrah mbretit pa krenari që të verbon...  
Nëse armiku, apo miku s'të bëjnë dot të vuash  
dhe gjithkënd e çmon, por veç sa meriton  
Në mundësh t'i mbushësh ti minutat  
që të rënda me veprat që peshojnë  
dije dhe mos ke asnje dyshim,  
se e jotja do jetë bota me çka brenda  
dhe burrë do t'jesh o biri im.

## VLERË NË SHTEPI!

Muzeu dioqezan ekspozoi me 9 Mars 2019, veprat e piktorit të famshëm Lin Delija, i cili gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë artistike dëshmoi energjikisht identitetin e prejardhjes. Kësaj bërë të njohur përpara opinionit ndërkombëtar, vlerat, doket, kostumet dhe orientimet psikosociale të kombit në përfaqësim. Veprimtaria u organizua nga shoqata



**Lin Delija**  
Piktor Shkodran i cili do të vlerësohet si artist i madh në shumë vende të botës, me në fund i prezantohet edhe publikut Shqiptar në Muzeun Historik Kombëtar nga datat 3-15 Qershor 2019.

kulturore "Lin Delija Art" dhe Arqipeshkëvia Shkodër-Pult. Të prashmit ishin të shumtë, ndër to dhe personalitetet e qytetit me në krye Zonjën Voltana Ademi, e cila kishte ndjekur artistin edhe në veprimtaritë e zhvilluara në Itali.

Në realizimin e kësaj veprimtarie, në kuadër të 25 vjetorit të mungesës së piktorit të madh, dhanë ndihmesë të çmueshme morale dhe ekonomike Imzot Angelo Massafra, konsulli i nderit i republikës së Austrisë z. Gjergj Leqejza, si dhe bashkëpunim të vyer Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", shoqata "Drejtësi dhe Paqe" dhe shoqata Atdhetare "Dukagjini".

Punimet artistike të kësaj ekspozite me titull: "Lin Delija në shtëpi", kryesisht elegancë e lapsit, pra vizatime, janë një dhuratë e koleksionistëve; Armando Nicoletti-t dhe Giuseppe Grassi-t për Arqipeshvinë Shkodër-Pult, me objektivin e një muzeu kushtuar artistit tonë. Lin Delija shpërfaqti në këtë ekspozitë fizionomitë e personazheve të përditshmërisë së vendit ku jetoi prej vitesh. Kuratori i ekspozitës Dr. Rubin Mandia shprehet mjaft entuziast për ardhjen e veprave artistike në qytetin e lindjes së piktorit, duke i cilësuar ato si vlera që kthehen në vatrën e pikënisjes së rugëtimit artistik të Delisë.

Lin Delija bën pjesë në plejadën e personalitetëve kombëtare, të cilët u larguan nga atdheu si rezultat i trysnisë që ushtroi pushteti diktatorial i instaluar i komunizmit hoxhist. Në kundërshtim të plotë ndaj dhunës pushtetare, Delija pasqyroi Shqipërinë e virtytit dhe të aspiratave evropiane. Pa mëdyshje ai mbarti dhe brendësoi atë Shqipëri që ishte dhe mbet evropiane, të cilën e përfaqësoi denjësisht deri në njësim, për të përmbushur aforiz-



min Jungian, kur thotë se, "Atë që bën një komb e bën edhe një individ dhe atë që bën një individ e bën edhe një komb".

Falë cilësive individuale, si dhe përmasave të personalitetit, artisti gëzon një

sërë ofiqesh dhe respektesh kombëtare dhe ndërkombëtare, ku ndër të tjera vlen të përmendet titulli "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", urdhrin e lartë "Nderi i Kombit", dhënë nga presidenti Topi, "Mirënjohje" nga Kuvendi Popullor, dhënë nga kryetarja Zj. Topalli e të tjera.

Në nder të artistit, që na nderon kemi dy shoqata në binjakëzim, që mbartin emrin e tij, njëra në Antrodoco, Itali dhe tjetra në Shkodër. Qëllimi dhe objektivat e këtyre dy shoqatave janë promovimi dhe evidentimi i vlerave artistike dhe stilistike të veprës dhe filozofisë së jetës së Delisë. Synim tjetër i shoqatës kulturore "Lin Delija Art", është studimi i Delisë në akademinë e arteve pamore shqiptare.

Urojmë që të kemi më shpesh praninë e trupit artistik të Lin Delisë në trojet tona, kësaj shtojmë vlerat në shtëpi.

Presidenti Shoqatës Kulturore "Lin Delija Art"

Nga **Tomas (Delija) Vata**

# NJI JETË PËR FE' E ATDHE'

- Veprimtari kushtuar 70-vjetorit të ndarjes nga jeta të martirit Vinçenc Prennushi -

Shqipnia vijon të jetë nën sundimin otoman.

Ndërkohë, diku në periferi të Shkodrës (Shirokë), Gjoni dhe Drandja presin lindjen e një fëmije.

Është data 4 shtator e vitit 1885 kur Kolë Prennushi vjen në jetë.

Kalvari i Kolës do të nisë vetëm pak ditë pas ardhjes së tij në jetë, pasi motra e tij binjake do të vdesë pak ditë pas lindjes, por ai vetë do të mbijetojë.

Në moshën 7 vjeçare ai fillon shkollën e Fretërve Minorë në Shkodër duke e vijue 7 vjet ma vonë, në vitin 1900, me noviciatin po të frenit. Në vitin 1904 ndjek kursin e teologjisë në Tirol (Austri) dhe atje, po në të njëjtin vit, kryen edhe kushtet e përjetshme.

Me 19 Mars 1908 shugurohet meshtar dhe kthehet në Shqipni tue vazhduë veprimtarinë e tij letrare, artistike, kulturore dhe atdhetare.

Në vitin 1926 At Vinçenci emnohet provincial i Fretërve Minorë.

Me 27 Janar 1936 Papa Piu XI e emëron atë Ipeshkëv të Sapës dhe me 26 Qershor 1940 Arqipeshkëv të Durrësit tue u ba kështu kleriku më i naltë dhe i rand-sishëm i Kishës Katolike në Shqipni.

Pozitat e Imzot Prennushit do të vështirësohen pa kthim në vitin 1945 kur ai dhe Imzot Gaspër Thaçi thirren nga Enver Hoxha dhe u kërkon atyre që kisha në Shqipni të jetë e ndarë nga Roma dhe të krijohet një kishë e re kombëtare.

Klerikët refuzojnë dhe kjo çon në arrestimin e Imzot Prennushit, me 19 Maj 1947 dhe dënimin e tij me 20 vjet burg, me akuza të rreme si bashkëpunëtor me fashistët, spiun i Vatikanit, komplot kundër popullit e të tjera.

Imzot Prennushi u mbrojt me këto fjalë: “Gjatë gjithë jetës teme kurrë nuk kam mendue apo veprue keq kundrejt të tjerëve. Gjithmonë kam kërkuë të bëj mirë për të gjithë, pa dallim”. Megjithatë, kjo nuk i mjaftoi atij të shpëtonte veten

nga dënimi me 20 vjet punë të detyrueme.

Pas disa muajsh vuajtjeje, Imzot Prennushi vdes me 19 Mars 1949, në përvjetorin e shugurimit të tij meshtarak.



EMZOT VINÇENC PRENNUSHI O.F.M.

Pas vdekjes trupi do t'i kthehet familjes dhe vëllai i tij, me ndihmën e disa të afërmeve e miqve, vuri trupin në një arkivol të improvizuar dhe e varrosi atë fshehurazi në katedralen e Durrësit.

Megjithatë trupi i tij nuk do të gjejë qetësi, pasi në vitin 1967, pak para ndalimit të plotë të besimit, trupi i tij u nxor nga varri dhe u tret diku në kodra.

Ishte një damnatio memoriae (lat. mallkim i kujtesës), rezervuar për ata që nuk kishin pranuar të ishin pjesë e njerëzve të rinj të regjimit.

Me 5 Nëntor 2016, në katedralen e Sh. Shtjefnit në Shkodër do të bëhej lumturimi i 38 martirëve të kishës në Shqipni dhe kjo listë do të kryesohej pikërisht nga Imzot Vinçenc Prennushi.

Në përkujtimin e 70 vjetorit të vdekjes (19 Mars 1949) të këtij atdhetari të madh

të kombit shqiptar dhe figure të shquar të klerit katolik, dita e 23-të e muajit të tretë të vitit 2019 iu kushtua këtij personaliteti, i cili për dashuni të atdheut dhe të besimit të tij të fortë në Krishtin, arriti deri aty sa të flijojë edhe veten e tij për këto ideale.

Si për ko incidencë, data 23 përkoi edhe me 70 vjetorin e lindjes së Imzot Angelo Massafra, Archipeshkëv Metropolit i Di- oqezes Shkodër – Pult.

Në nder të kësaj ngjarjeje në katedralen e Sh. Shtjefnit në Shkodër, u celebrua mesha e shenjtë e cila u drejtua nga vetë Imzot Massafra. Të pranishëm ishin shumë Ipeshkvinj dhe meshtarë të urdhrave të ndryshëm. Gjithashtu nuk mungoi edhe Nunci Apostolik Imzot Charles John Brown, i cili u emërua në këtë post nga Papa Françesku, me 9 Mars 2017.

Në këtë celebrim ishte i pranishëm edhe At Nikolla Petani, famullitar i Kishës Ortodokse në Shkodër.

Pas celebrimit të meshës, Imzot Massafra iu drejtua besimtarëve duke i falenderuar ata për mbështetjen dhe lutjet e tyre në përmbushje të misionit të tij si Arqipeshkëv.

Në pasditen e po kësaj dite, Arqipeshkëvia Shkodër – Pult, Komisioni “Drejtësi dhe Paqe” dhe Shoqata Kulturore Artistike “Prekë Jakova” duke filluar prej orës 16. 00, në ambientet e kishës së motrave Stigmatine, organizuan një aktivitet letraro – artistik në nder të figurës së Imzot Vinçenc Prennushit dhe në përkujtim të 70 vjetorit të vdekjes.

Veprimtaria u mbështet financiarisht nga organizata gjermane Renovabis.

Veprimtaria filloi me paraqitjen e librit, me titull “Nji jetë për Fe’ e Atdhe’”, me autor prof. Alfred Çapalikun dhe me redaktim të Robert Prennushit, nip i të lumit Vinçenc Prennushi.

U vijua me disa fjalime të shkurta nga z. Luigj Mila, Drejtor Ekzekutiv i Komisionit “Drejtësi dhe Paqe” dhe z. Robert

Prennushi.

Pas një paraqitjeje të shkurtë të jetës dhe veprave të Imzot Prennushit nga të dy lektorët, veprimtaria vijoi me paraqitjen e një dokumentari mbi jetën e Imzot Prennushit.

Dokumentari ishte i përgatitur nga zj. Tefta Radi dhe i ripunuar nga gazetari i Ergys Kavaja. Pas përfundimit të dokumentarit, rreth orës 17. 00, ishte organizuar një shfaqje letraro – muzikore, me titull “Bija Shqiptare”, me poezi të Imzot Vinçenc Prennushit dhe muzikë të At Martin Gjokës.

Situata e paraqitur në këtë veprim letrar ishte e ajo e vitit 1913, kur Shkodra ishte e rrethuar nga ushtritë malazeze dhe Shqipnia rrezikonte copëtimin.

Shfaqja ishte e shoqëruar nga kuinteti i Universitetit të Arteve – Tiranë nga kori i fëmijëve dhe e dirigjuar nga prof. Gjon Shllaku.

Në veprimtari ishin të pranishëm familjarë dhe të afërm të Imzot Prennushit, disa prej të cilëve të ardhur nga jashtë vendit posaçërisht për të marrë pjesë në këtë veprimtari. Imzot Angelo Massafra, i cili ishte i pranishëm jo vetëm si i ftuar, por edhe si person i përfshirë drejtëpërdrejtë në organizimin e kësaj veprimtarie, gjithashtu ishte e pranishme edhe zj. Voltana Ademi, kryetare e Bashkisë Shkodër, e cila ofroi mbështetjen e saj dhe të institucionit që ajo drejton për vijimin e zhvillimit të veprimtarive të tilla. Gjithashtu ishte pranishme dhe Kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër, zonja Gerta Bardeli.

Ishin të pranishëm edhe shumë personalitete të tjera të fushave të ndryshme të jetës kulturore dhe artistike të qytetit të Shkodrës.

Mbrëmja u mbyll me një koktej për të pranishmit po në mjedisin e motrave Stigmatine.

Majk Mila

## PËRURORHET MONOGRAFIA E GJIMNAZIT “SKËNDERBEU” NË DITËN E SHKOLLËS

2 Marsi, Dita e Shkollës e Gjimnazit “Skënderbeu”, këtë vit u madhështua me përrurimin e Monografisë së shkollës sonë. Në këtë solemnitet të 51 vjetorit të Gjimnazit, të pranishëm ishin maturanët e gjeneratës së parë të Gjimnazit, veteranë të arsimit, ish-drejtorë, zyrtarë lokalë e qendrorë, përfaqësues të familjeve të dëshmorëve e të shkollave simotra, mësimsdhënës e nxënës.

Përrurimi u hap nga drejtori i Gjimnazit “Skënderbeu” në Kaçanik z. Ibush Vishi, i

cili falënderoi të gjithë ata që kontribuan që ky libër ta shohë dritën e botimit. Ai tha se Monografia është mënyra më e mirë për ta ruajtur historikun e Gjimnazit, në mënyrë që lexuesit t’i ofrohet informacion e motivacion kujtese e frymëzimi. Kryetari i Komunës së Kaçanikut z. Besim Ilazi, tha se këmbëngulësia dhe kontributi i njerëzve të dijes bënë që Kaçaniku të ketë shkollë të mesme në një periudhë mjaft të vështirë të historisë së vendit tonë. Ndërsa ish-drejtori i Gjimnazit z. Latif Nallbani, tha se me punë kanë tejkaluar shumë sfida, duke veçuar synimin që t’i bindin prindërit për t’i regjistruar fëmijët e tyre në Gjimnaz. Mungesa e lokalit shkollor e kuadrit mësues, u përmend edhe nga ish-drejtori Remzi Çaka, i cili shtoi se përkundër këtyre pengesave, arritën që Gjimnazin “Skënderbeu” ta bëjnë shkollë model dhe e tillë vazhdon të jetë edhe sot. Për kontributin e tij të pakursyer për botimin e librit “Monografi”, drejtori i Gjimnazit i dhuroi z. Çaka portretin e

Skënderbeut. Ndërsa kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, z. Ndue Sanaj, me titullin e nderit “Mehmet Shpendi” nderoi ish-profesorin e Gjimnazit, dëshmorin Nevzat Çallaku, dhe dëshmoren Emsale Frangu, për të vijuar me titullin “Mirënjohja Martin Camaj” që iu nda Gjimnazit tonë.

Takimin e përsëritën edhe djali i ish-drejtorit të Gjimnazit Bedri Hysa, ambasador Ylber Hysa, mbesa e ish kryetarit Sali Bajra, Gjentile Bajra, si dhe nxënësi i gjeneratës së parë të maturanëve të

Gjimnazit, z. Nuri Rexhepi.

Nuk kishte si të mungonte edhe një program i pasur kulturo-artistik i përgatitur nga nxënësit tanë. Programi u begatua me praninë e flautistes nga Ferizaj, profesoreshës Blenda Konxheli, e cila interpretoi pika muzikore shoqëruar në piano nga prof. Fatjona Malsiu.

Ndërsa, me moderimin e mrekulueshëm të saj, shkëlqim të veçantë këtij solemniteti i dha edhe prof. Ariana Çaka...

Nga Fitore Bilalli



# KAÇANIKU, VATËR E QËNDRESËS DHE E DIJES

Në vijimin e bashkëpunimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me shoqata dhe institucione të Kosovës, ishte dhe veprimtaria, që organizoi gjimnazi "Skënderbeu", në Kaçanik. Ftesa e ardhur nga drejtorja e këtij gjimnazi, për të marrë pjesë në paraqitjen e daljes nga shtypi të monografisë të këtij gjimnazi, beri që një grup nga kryesia e shoqatës tonë, me drejtues z. Ndue Sanaj, të udhëtonte drejt Kosovës, me datën .01. 03. 2019.

Çdo njëri nga ne, ndjen emocion kur udhëton për në Kosovë, në pjesën më të martirizuar të tokës Arbërore, por dhe më qëndrestare. Le pastaj, kur mundësia të jep të njohësh nga afër edhe më shumë vlera nga sa dimë për Kaçanikun, për këtë vatër, prush, zjarr e flakë përherë e ndezur kundër pushtuesve në shekuj

Kënga "Ushton gryka e Kaçanikut", me tekst, kompozitorë e këngëtare shkodrane, është një argument dhe pasaportë, vlerë e shtuar, që në komunën e Kaçanikut të ndjehemi mes vëllezërish.

Ka disa variante toponimi i emrit Kaçanik, që kanë fillimet e tyre, që në fillim të shekullit XV, por sipas historianit Tofik Raka, toponimi Kaçanik është i lidhur, me emrin Nike dhe vijon, me Pal Don Nika, feudal shqiptar nga ajo zone. Në Kaçanik njihen shumë emra vendesh, që përfundojnë me Nike, si Ara e Nikes, Pusi i Nikes, Kisha e Nikës, Livadhi i Nikes e të tjera, të cilat ishin prona të Pal Don Nikes. Themelet e qytetit të sotëm të Kaçanikut, njihen nga fundi i shekullit XVI. Por Kaçaniku, nuk ka kuptim pa Gryken e Kaçanikut, një vend strategjik, për mbrojtje, ku janë thyer ushtri nga më të fuqishmet të kohës, duke u kthyer në aleate e përhershme të luftëtarëve shqiptarë në betejë. Mes shume betejash të përgjakshme në lufte për liri nder shekuj veçohet ajo e vitit 1910, kundër Dergut Pashës dhe 1913 kundër serbeve, të udhëhequra nga trimi Idriz Seferi

Kaçaniku i sotëm ka një sipërfaqe 306 kilometër katrorë dhe shtrihet në jug të Kosovës. Nëpër Kaçanik kalon autostrada Shkup - Prishtinë, si dhe hekurudha Selanik - Fushe Kosove.

Përkrah luftës për liri e pavarësi, kaçanikasit luftuan për shkolle, gjuhe e kulture shqipe, sepse një popull i pashkolluar, me nivel të ulët kulturor dhe arsimor, përçahet, nënshtrohet dhe mbahet i pushuar më lehtë. Ketë e gjejmë të përshkruar dhe argumentuar në librin "Monografi e Gjimnazit "Skënderbeu" Kaçanik. Përpjekjet e patriotëve shqiptarë, në mbarë trojet shqiptare, ka qene e vijuar, për hapjen e shkollave shqipe dhe përdorimin e gjuhës amtare, kundër të mësuarit gjuhëve të pushtuesve. Si rezultat i këtyre përpjekjeve edhe në Kosove shkolla e pare shqipe është hapur në kishën e Shëngjergjit, në Stubell, në vitin 1584. Sigurisht, që roli kishës dhe i klerit ka qënë i rëndësishëm për periudhat e hershme, por dhe të kohës së rilindësve.

Çdo përpjekje dhe arritje në përhapjen e shkollës shqipe në Shqipëri, reflektohej dhe në Kosovë, me kuadër mësimdhënës të kualifikuar, bazë materiale, eksperiencë organizimi e të tjera, para Luftës së Dytë Botërore e deri në vitin 1948, kur

politika e dy vendeve tona u ndanë për arsye, që dihen nga historia. Këto përpjekje janë të evidentuara dhe në Kaçanik, nga patriot dashamirës të zjarrtë të shkollës, dijes dhe kulturës kombëtare. Hapja e shkollës fillore, që u pagëzua me emrin e heroit Emin Duraku, që arritje e madhe, duke përballuar presionin e regjimit, por dhe të mentalitetit për shkollimin e të rinjve e në veçanti të vajzave.

Puna e madhe e intelektualëve dhe të patriotëve, kërkesat e kohës për gjenerata të reja të arsimuara, të afta për të sfiduar presionin serb, që donte ta mbante nën presion, si gjithë Kosovën dhe Kaçanikun, u be e mundur të hapet gjimnazi, duke vendosur emrin "Skënderbeu" dhe duke filluar punë me 1 Shtator 1967, si fillim me dy paralele, me gjithsej 62 nxënës, nga këta 10 vajza dhe 52 djem.

Edhe pse, presioni i regjimit sillte pengesa dhe vështirësi në realizimin e misionit, të edukimit shkencore dhe shoqëror, ky gjimnaz u shndërrua, në një vatër të rëndësishme të përgatitjes të brezit të ri, të aftë për të përballuar sfidat që do imponohej jeta. Gjeneratat e mësuesve të përkushtuar, që kjo shkolle, puna dhe veprimtaria e saj të vihet në baza shkencore dhe bashkëkohore, kane arritur nivele të larta, në arritjen e objektivave, duke bashkëpunuar dhe me bashkësinë, me pjesën intelektuale e përparimtare, me sipërmarrës, me pjesën e shëndetshme të pushtetit vendor. Gjimnazi "Skënderbeu" ishte vatër e rëndësishme e qëndresës duke marrë pjesë aktive në lëvizjet dhe revoltat popullore, kundër regjimit serb, për të drejta, liri dhe pavarësi, duke përballuar dhunën, burgosjet, përkrah qëndrestarve, trimave e trimëshave të Kaçanikut. Vetëm në luftën e fundit për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, nga Kaçaniku rënë dëshmorë 96 ushtarë të UCK- së, 140 civil dhe 6 të tjerë rezultojnë të zhdukur. Mes shumë vështirësish, luftash dhe përpjekjesh, Gjimnazi "Skënderbeu" ka ardhur duke u rritur, si në cilësi, masivitet, e bashkëpunim në përcjellje eksperiencash nga një gjeneratë në tjetrën. Vetëm për vitin shkollor 2017 -2018, në këtë gjimnaz kanë frekuentuar 3 223 nxënës nga këta 1 756 femra.

Monografia e Gjimnazit "Skënderbeu" paraqet historikun e arritjeve, të renditura me kujdes nga personalitetet, që kanë

drejtuar, kontribuar e menaxhuar jetën, punën dhe veprimtarinë e këtij gjimnazi, duke u bërë faktor argumentues dhe nxitës për arritje të reja, për brezat që do të kalojnë në këtë vatër të dijes.

\*\*\*

Në emër të Shoqatës Atdhetare "Du-

në fushën e arsimit e të kulturës;

Së dyti, treguat vitalitetin dhe përgjegjësinë arsimore e atdhetare të autorëve të kësaj monografie, si dhe në tërësi të personelit pedagogjik e të nxënësve të kësaj shkolle;

Së treti, e vutë në punë edhe Kryesinë



kagjini", përhëndeti Kryetari i saj, Ndue Sanaj, i cili në mes të tjerave theksoj: "Vëllezër e motra!

Është shumë e dhimbshme jeta e atyre, që kanë rënë dëshmorë dhe që janë martirizuar për jetën e kësaj shkolle, në luftë me pushtuesin serb, si vëllezërit dhe motrat tona këtu, profesorë, punëtorë e nxënës: Nevzat Çallaku, Emsale Frangu,

e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", që me përgjegjësi ta analizojë edhe punën e shkollës suaj... Prandaj, Shoqata jonë vendosi:

1-Të nderojë dëshmorët e kësaj shkolle, me titullin "Mehmet Shpendi", profesorin Nevzat M. Çallaku dhe nxënësen Emsale Z. Frangu, me motivacionin: "Për heroizëm të jashtëzakonshëm në mbrojtje



Murat Raka, Minah Kuqi, Naser Loku, Danush Kuqi, Ilir Caka...

Siç na lënë mbresë të veçantë dhe personalitetet dhe figurat e mëdha kombëtare, që kanë dale po nga kjo shkolle: mjekë, shkrimtarë, dramaturgë, regjisorë e të tjerë; si dhe mikja jonë e re e në perspektivë, ish-nxënësjua juaj Fitore Bilalli. Ju lumtë!

Brezat e ardhshëm do jenë krenarë për punën e bërë dhe që po bëni! Ndërkaq, me ftesën që na keni drejtuar, u bënë tre të mira:

Së pari, u forcuan më tej marrëdhëniet në mes Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe Gjimnazit "Skënderbeu", në veçanti

të Atdheut, duke u flijuar për të mbetur të përjetshëm në kujtesën e brezave";

2-Të nderojë Gjimnazin "Skënderbeu" në Kaçanik, me titullin "Mirënjohja Martin Camaj", me motivacionin: "Një ndër shkollat e vjetra të shkollimit të mesëm shqip, e shquar për suksese, për rezistencë kombëtare dhe për përgatitjen e personaliteteve në të gjitha fushat e jetës shoqërore e të shkencës"

Përgatitur nga  
Zef Bari,  
mars 2019

# NJË LIBËR, ME MESAZHE TË SHKËLQYERA TË SHQIPTARIZMIT

Lexova me interes e përgjegjësi librin "Historiku i Familjes Sanaj" i studiuesit e gazetarit, kolonelit në pension, Ndue Sanaj, që me përkushtim e profesionalizem qëndroi për disa dekada në krye të detyrës për mbrojtjen e Atdheut.

Letra e kryetarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", që nga themelimi i saj me 13 Maj 2003, më surprizoj. Po marë disa rreshta nga libri, i komunikimit të tij me të gjithë pjestarët e Familjes së Madhe Sanaj, me imazhet e karakteristikat e tyre, të cilat janë burim krenarie, dinjiteti e frymëzimi për vendlindjen Gjuraj, Dukagjinin, Shkodër Locen dhe Nanëmadhen Shqipëri. "Secili nga ne, thotë autori i librit, ka kujtimet e veta, se ata janë jeta e jote, se ata përbëjnë historinë e jetës tënde, historinë e njerëzvet më të dashur, prandej kujdesu për kujtimet e tua sepse në radhë të parë nuk mund ti jetosh përsëri."


Hulumtimet e z.Ndue Sanaj rrokin disa fusha të shkencave albanologjike e social – gjeo - ekonomike me tematikë sa vijon: "Pak mbi origjinin e shqiptarëve", "Prejardhja e emrit Shqiptar", "Prejardhja e Gjuhës Shqipe", "Fillimet e Shkrimit Shqip", "Ngjarjet më të rëndësishme në jetën e banorëve të fshatit Gjuraj", e të tjera. Në fund Mbyllja, "Disa Porosi të veçanta dhe Amaneti".

Mbyllja e librit është impresionues dhe MESAZHI i juaj, "Ruajeni si sytë e ballit Shenjtërinë e Historisë së identitetit tuaj të lartë! Mos e përgojuj nderin e saj, se

*i tmerrshëm do të jetë i fundi i brezave që do vijjnë", na detyron të zhytemi në mendime të thella për t'i hedhur më shumë dritë misterit të rreziqeve të së ardhmes të pa sigurt që na prët! "Është e vertetë që ai në leximin e parë, duket pak i vrazhdë, jo i ëmbël, sikur po nemi pasardhësit, brezat që do vijjnë, të ardhmen dhe jetën e tyre!"*

Por, nuk është ashtu. Autori u drejtohet brezave që jetojnë, bashkombësve të tij. Ku janë ata...? Ku kanë shkuar? Sigurisht në rrugët e kurbetit për një jetë ndryshe, më të mirë. Po Atdheu, Dukagjini, prindërit, fëmijët e të tjerët me radhë si dhe me kë jetojnë...? Kujt ia kanë lanë...? Kush i ndihmon...? Ata kanë nevojë për më shumë dashuri, përkrahje shërbime dhe kontribute. Shqipëria fillon te familja, gurët e oborrit, lagjësia, fshati, rrugica, pragu i shtëpisë e votra e zjarrit. Atje janë shpirti dhe zemra e saj! Ah, zemra e nanës...! Nuk krahasohet me asgjë...!

Globalizmi, një e ardhme e pa sigurt me shumë të panjohura, kontradikta, rreziqe, avantazhe e të papritura! Gjithashtu edhe shkalla më e lartë dhe e fundit e Kapitalizmit të markës "Made In Adam Smith" drejt performancave më të sofistikuar të jetës së tij të limituar. Sigurisht dëmet i paguajnë popujt, veçanërisht vendët e vogla...! Ata po zgjohen! Strategjia e Globalizmit sundim absolut i gjigandëve të Oligarkisë Financiare Botërore. E ardhmja rezultante e probabilitetit të forcave të bashkuara të Njerëzimit për pakësimin



drejt eliminimit të pasojave dhe rreziqeve apokaliptike nga Sera, Ngrohja Globale, Gara e Çfrenuar e Armarimit Bërthamor, Varfëria Ekstreme, Ajzbergët e Pasurive Miliardere e të tjera.

Mos pyet se çfarë mund të bëjë vendi yt për ty, por pyet ç'mund të bësh ti për vendin tënd", Xhon Kenedi. Fjalë lapidare...! Burim Frymëzimi...! Edhe libri i juaj "Një libër me mesazhe të shkëlqyera

të shqiptarizmit".

Por një armik i fuqishëm, joshës dhe agresiv, që ndodhet i fshehur në një "tunel" të errët të thellësive të mëdha, godet pa pushim për të kultivuar në shpirtërat e njerëzvet "Kozmopolizmin". Në shënjestër nacionalizmi, atdheadashria, gjuha, kultura, letërsia, artët, vetë ekzistenca e kombëve.

Para disa vitëve takova dikund afër monumentit të Heroit të Popullit Isa Boletini Shkodër, një ish punonjës të ndërmarrjes me të birin e tij rreth 10 vjeç dhe, pasi u përshëndetëm, u interesova për mbarëvatjen e djalit në mësim. Ai, në moment si duke qeshur, me një lloj krenarie prej injoranti tha: "Jo, jo, nuk di shqip!!!" Si kështu?! Djali, almet djali, nuk di shqip! Çka i duhet shqipja, gjuha e nanës, i thashë me shqetësim, ironi e keqardhje bashkëbiseduesit

tim kozmopolit i mbushur deri në fyt me nacionalizëm helenik.

Ju faleminderit!

**Nga Luigj Temali**

Shkodër 25 Shkurt 2019

## CARLETON COON: PORTRETET E VIGANËVE TË SHQIPËRISË SË VERIUT

Një studiues amerikan i quajtur Carleton Coon, ka realizuar një studim gjatë viteve 30 të shekullit të kaluar, në malësinë e mbi Drinit. Ky studim është botuar në formën e një libri në 1950 me titullin: "Malësia e viganëve: studim racor dhe kulturor i fiseve të malësisë së Shqipërisë së Veriut...!" Përveç të dhenave antropometrike (matje të kryera në vend), ky botim përmban edhe fotografi të rralla të realizuar në malësitë e veriut të Shqipërisë nga ky antropolog amerikan.


Raca e shqiptarëve kishte karakteristika të atilla, që e bëri antropologun amerikan Carleton Coon të kalonte thajse një vit udhëve të veriut të Shqipërisë. Ai udhëtoi në fshatrat më të thella të malësisë së veriut, ku Coon gjeti karakteret që i duheshin për studimet e tij. Atje, ky studi-

ues takoi burra, gra, fëmijë e pleq. Banorët thoshin që ai bënte ca matje të çuditshme, që këtyre banorëve ju dukeshin si diçka jo e zakonshme. Ai studionte tiparet e portretit, pamjet e formën e fytyrës, gjatësinë trupore, gjymtyrët, flokët...

Studiuesi Carleton Coon, përveç matjeve, i fotografonte thajse të gjithë malësorët gegë që takonte. Me aparatit e tij fiksonte portretin ballor dhe profilin. Në të njëjtën kohë, ai gjithashtu mbante shënime për secilin prej tyre, pas matjeve të hollësishme që ju bënte. Ai ka qënë shumë i dhënë pas detajeve dhe tipareve të veçanta të njerëzve që ai takoi.

Në këtë udhëtim e shoqëronte një mik i afërt i tij shqiptar, të cilin e kishte punësuar si asistent, që quhej Stavri Frashëri. Falë kësaj dysheje të cilët qëmtinin karakteristikat e racës shqiptare maleve të veriut të Shqipërisë përgjatë vitit 1929-1930, sot kemi të dokumentuar të dhëna shumë të rëndësishme mbi antropologjinë e gegëve, të cilat së bashku me studimin e tij dhe një album me foto të zgjedhura që Carleton Coon i botoi në librin e tij "Malësia e viganëve: studim racor dhe kulturor i fiseve të malësisë së Shqipërisë së Veriut", botuar në Kembrixh më 1950.

Coon lindi në Masaçusets në vitin 1904. Studioi fillimisht për egjiptologji dhe antropologji në Universitetin e Harvardit, degë për të cilat u diplomua në vitin 1925. Në këtë drejtim ai kreu kërkime dhe punoi si asistent dhe profesor



në Universitetin e Harvardit. Më tej, po në fushën e antropologjisë, ai dha mësim edhe në Universitetin e Pensilvanisë (1948-1963). Gjatë kësaj periudhe ideoi dhe realizoi edhe muzeun universitar të Filadelfias.

Studiuesi Robert Elsie ka shkruar: "Gjatë viteve 1929-1930 Carleton Coon ndodhej në Shqipëri, ku kreu një studim antropometrik mbi 1.067 shqiptarë të dhjetë zonave të Veriut, duke iu matur madhësitë dhe format e trupave të tyre. Ky studim u përfundua në vitet 1946-1947 me ndihmën e komunitetit shqiptar të Bostonit".

Puna e Coon, ka qënë e tejet e lodhshme, voluminoze, kërkimet të gjata, një punë që në fund duket se nuk i dha autorit

frytet që ai priste. Jehona shkencore e punës kërkimore ishte e kufizuar, meqë "pas Luftës së Dytë Botërore, studime të tilla të antropologjisë fizike dhe të tipareve racore u bënë tabu apo kishin humbur interes", sqaron studiuesi Robert Elsie, duke shtuar se interes të veçantë ngjallin fotografitë që Coon realizoi gjatë udhëtimeve nëpër dhjetë zonat e veriut shqiptar.

Përveç këtij studimi dhe të fotove të përfshira në të, me mjaft interes janë edhe fotot që mblodhi e botoi nga ana e tij Stavri Frashëri në librin e tij "Përmasë Mirditës në dimër", botuar në Korçë më 1930 dhe në versionin anglisht "Through Mirdite in Winter". Me materialet fotografike të këtyre dy autorëve, studiuesi Elsie ka ndërtuar një album të veçantë, të cilin e kishte promovuar në faqen e tij.

Duke e parë këtë punë kaq voluminoze të bërë nga studiuesi Coon, ndihmësi i tij Frashëri, por edhe nga R. Elsie e shumë të huaj të tjerë që janë interesuar për Shqipërinë, mund të themi se ne nuk po bëjmë sa duhet: as në fushën e studimeve, as në atë të promovimit të punës studimore të kryer nga studiuesit e huaj. Është me rëndësi që vlerësojmë punën e bërë nga parardhësit, ta prezantojmë atë si për breast tanë ashtu edhe për të huaj të tjerë që nuk e njohin si duhet Shqipërinë.

Nga Pjetër GJETA



# NIKOLIN GJELOSHI, NJË PROFIL I PA-AUTORIZUAR

Për Nikolin Gjelosin mund të thuhet shumë epitete për ta përcaktuar, të tilla si: emigrant i suksesshëm, sipërmarrësi i parë shqiptarë në Toskanë, shqiptari për të cilin figurë e shquar italiane ka shkruar një libër, Njeriu i suksesit, Ambasador i Kombit, e kështu në vijim. Por, fillimisht e mbi të gjitha duhet të themi se Nikolin Gjeloshi është një djalë i mirë i Dukagjinit, i lindur më 11 Shkurt të vitit 1969 në Nënnavriq të Shalës. Pasi përfundoi me sukses shkollimin e mesëm në Breg Lumi (një shkollë me emër në atë periudhë), filloi studimet në Akademinë e Rendit (duke qënë njëkohësisht edhe në punë, në forcat e rendit). Mirëpo, si ato që shikonte në terren, ashtu edhe perspektiva, nuk i pëlqenin, për pasojë, në fillim të vitit 1993, vendosi të largohet nga Shqipëria.

U vendos në vendin fqinj, Itali, ku për rreth 3 vite punoi në një fshat të Sicilisë, i quajtur Barcelona Pozzodigoto Messina. Gjatë këtyre viteve, hasi në vështirësitë e një emigrati, ashtu edhe presionin e mafias siciliane. Për pasojë, u transerua në Toscana, ku vazhdon të jetë edhe sot. Këtu, e filloi punën në ndërtim, si ndimës murator, një punë jo e lehtë, por një zgjidhje për emigrantin e papërkrahur. Në vitin 1996, ai u informua se ishte e mundur

(sipas legjislacionit Italian) që të kërkonte institucioneve Italiane, që ai të paisej me një licensë, e cila i jepte të drejtën për të punuar për llogarinë e tij, si një sipërmarrës firme. Pasi bëri kërkesën Kuesturës së Firenzës, nuk e pranuan, mori avokat dhe hodhi në gjyq Kosturen e Firenzës, dhe pas 2 dy vitesh iu dha e drejta të marrë "Lejen e punës" (Permeso soggiorno per lavoro Autonomie). Që atëherë, Nikolini hapi firmën e tij dhe vazhdoi të punojë si një sipërmarrës i suksesshëm, me rezultate gjithnjë në ngritje. Sot është mjaft i njohur në gjithë zonën ku ushtron aktivitetin e tij, por edhe shumë më gjerë.

Në fillim, asnjë furnizues të materialeve të ndërtimit, nuk pranonte që ti jepte matrialin për ndërtim në emrin e tij. Për një farë kohe nuk dinte si t'ia bënte, por zgjidhja erdhi nëpërmjet një italian, me të cilin kishte raporte të mira shoqërore dhe e ndihmoi. Me të filluar punë me firmën e tij, ai nisi të shikojë edhe rezultatet e para të suksesit të vet. Prandaj, ai nuk u "mbyll" në vetvete, por eksperiencën e tij ua njoftoi edhe gjithë shqiptarëve të tjerë me banim në Itali që ai njihnte, duke i këshilluar të gjenin rrugën e biznesit të tyre. Dhe numri i shqiptarëve sipërmarrës (me firmë të regjistruar, në vitin 2010, në Itali, kalonte shifrën 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) taksa pagues shqiptarë për shtetin italian). Ky numër, e shtyri atë të mendojë që ishte e nevojshme të organizoheshin në një shoqatë për sipërmarrësit



shqiptarë në Itali. Dhe kjo ndoli: për herë të parë që u hap një shoqatë për sipërmarrësit shqiptarë në Itali, e quajtur "ASSOALBANIA". Menjëherë pas hapjes së shoqatës, filluan të kontaktohen institucionet italiane dhe ato shqiptare, gjithnjë në mbrojtje dhe në interes të sipërmarrjes shqiptare në Itali.

Punën individuale dhe me pronë personale, Nikolini ka menduar gjithmonë si të vetmen rrugë fitimprurëse, të ndershme dhe të sigurtë. Bindja e tij u përforcua me ndjenjën që imigrantët shfrytëzoheshin në "punët e krahut" dhe nuk paguheshin aq sa duhej. Ai mendon se tre kanë qënë

zultatet e arritura nga Z. Nikolin Gjeloshi. Ndër më të rëndësishmet mund të veçojmë:

- Në vitin 2011, në Toscana, i është dhënë titulli "Qytetar i Toskanës".
- Po në vitin 2011, ai ishte premiate me triologjinë: "Syri, mendja dhe dora".
- Në vitin 2012, është vlerësuar me titull përkrah firmës më të fuqishme në Europë, pronari i firmës "VANUCI PIANTE", i quajtur Vanino Vanuci.
- Ndërkohë që ka marrë disa çmime për librin e tij të titulluar: NIKO, Nikolin Gjeloshi citadini del mondo. (NIKO, Nikolin Gjeloshi qytetar i Botës).
- Qendra e Pistoia, për herë të parë i ka dhënë një të huaji çmimin më të lartë të qytetit, i quajtur "MICCO".
- Bashkia e Pukës e ka shpallur "Qytetar Nderi".
- Së fundi, u nderuar nga shteti me titullin prestigjioz "AMASADOR I KOMBIT".

Natyrisht që vazhda e çmimeve dhe e vlerësimeve nuk është në të ndalur, por vetë Nikolini është modest dhe thotë se çmimet që ka marrë, nuk janë thjeshtë një nderim për të, por është përpjekur që këtë ta shikojë si një nderim për gjithë shqiptarët e ndershëm dhe punëtorë. Nga ana tjetër, ai pohon se nuk do të reshtë me energjitë e tij që vlerësimet e marra, ti verë sa më shumë në funksion në opinionin italian për shqiptarët punëtorë dhe të ndershëm, duke lënë në hije edhe ata pak "keqbërës" që shpesh media i fryn si fenomen dhe si numër.

Nikolin Gjeloshi paraqet një rast unik të një imigranti të vitit 1993, në cilësinë e një sipërmarrësi shqiptar, subjekt i një libri ku rrëfëhet historia e tij nga fëmijëria deri më sot, me titullin: "Niko, Nikolin Gjeloshi, cittadino del mondo". Është shkruar nga Paolo Seganti, që është dhe aktor shumë i njohur dhe dashamir i shqiptarëve, në një farë mënyre si një "rrëfënjë për historinë dhe vuajtjet e shumë shqiptarëve si Nikolini". Me angazhimet serioze në punë dhe mundimet tipike të një imigranti, me vuajtjet dhe shpresat që janë bashkëdhëtare të tij, ai arrin të krijojë kompaninë EDIL-ALBO që nga viti 1998, dhe të bëhet i vetmi përfaqësues i firmës Del Taglia Piscine, me kontakte në të gjithë botën. Në figurën e Nikolinit të shfaqet



në një farë mënyre historia e mjaft prej emigrantëve shqiptarë që, prej fillimit të viteve '90 deri më sot, kanë ndryshuar shtresën, cilësinë dhe prospektivën e një populli, kanë luajtur rol të rëndësishëm në atë çka shpesh quajmë transformimi i imazhit dhe kulturës për integrimin e shq-



iptarëve në Itali që filloi 20 vjet më parë. Ndër vite, Nikolini është impenjuar edhe personalisht me organizimin e shoqatave për integrimin e shqiptarëve.

Te figura e Nikolini Gjeloshit, ne shikojmë një burrë të krahinës tonë i cili duke u bazuar në punën e tij të ndershme, në forcën e tij krijuese, në edukatën dhe respektin për punë n e ndershme, të cilat patjetër që do të japin rezultat. Ndaj, na mbetet që ta urojmë Nikolinit për gjithë arritjet e tij, të shpresojmë që këto arritje të shërbejnë si një rrugë që vazhdon, e njëkohësisht të shpresojmë që këtë rrugë ta ndjekin edhe të tjerë djem e vajza me origjinë nga Dukagjini, pse jo edhe nga Shkodra e nga gjithë Shqipëria.

Prof, as, dr. Zef Gjeta



motit e favorshme: E para që tregu i ndërtimit ishte gjithnjë e në zgjerim, ishte moment shumë i favorshëm për këtë sektor. E dyta, avantazhi i pashmangshëm ekonomik me bindjen në vetvete që po të punonte për llogarinë e tij dhe do të ndjehej më i stimuluar për punë, e cila nuk do ti mungonte, pasi kishte eksperiencën e duhur për marrëdhëniet e punës. E treta, ai donte që t'i siguronte vetes të drejtën për dokumente dhe të ndihej i stabilizuar për kohë të gjatë në atë vend që edhe kontribuonte me punë dhe arritjet e tij.

Puna e suksesëshme si sipërmarrës ndërtimi në Itali, ka ecur paralelisht me një jetë aktive në ndihmë të shqiptarëve që jetojnë në Itali, por edhe përkrahje për të afërm apo të tjerë të njohur të tij në Shqipëri. Dhe puna cilësore, me përkushtim dhe shumë e suksesëshme u shoqërua edhe me vlerësime për këtë "mendje të artë", të cilat padyshim janë vlerësime të merituar dhe të bazuara në punën dhe re-



# POETI NDRE MJEDA PËR GEORGE WASHINGTONIN

Nga Moikom Zeqo

Të nderosh Ndre Mjedën është veç të tjerash të ridimensionosh sistemin e vlerave të identitetit kombëtar, që për fajin tonë, të shqiptarëve, është i brishtë dhe mjerisht edhe “i harrueshëm”

Në 1 gusht 1937, pra 82 vjet më parë mbylli sytë përgjithmonë Ndre Mjeda.

Kishte lindur në vitin 1866 në Shkodër. Shprehja “mbylli sytë përgjithmonë” është një mënyrë konvencionale e të shprehurit. Sytë e Mjedës, nuk i përkasin misterit të vdekjes. Ata janë sy të pavdekshëm që, në të gjitha kuptimet e imagjinatës poetike, shohin gjithçka, me përdëllim dhe qetësi sokratike, paradokset dhe marrëzitë tona të ditës. Për një simetri, ndoshta krejt të rastësishme dhe aspak dinastike, kemi një rend numrash të përvejtoreve kryesorë të disa datave të Ndre Mjedës.

Në 1887, 132 vjet më parë Ndre Mjeda botoi poemën e jashtëzakonshme dhe njëkohësisht melankolike “Vaji i bilbilit”. Kurse në vitin 1970, në Vjenë të Austrisë poeti botoi librin e tij të parë dhe të fundit të jetës, të quajtur në një titull latin, vezullues dhe të përjetshëm “Juvenilja”.

Ky libër është padyshim një nga librat më të rëndësishëm të poezisë shqipe në 5 shekuj të ekzistencës së saj të shkruar, që nga Gjon Buzuku e deri më sot. Tërë këto data të shënuara, me grishje të thella idesh dhe nocionesh të mëdha.

Nuk di nëse ka ndonjë projekt nderimi dhe përkujtimi Ministria e Kulturës. Ç’dreqin janë tërë këta ministra efemeridë të kulturës, që kanë vetëm lidhje rastësore me kulturën shqiptare, por që nuk kuptojnë asgjë prej thelbit inkandeshent dhe të amëshuar të kësaj kulture.

Të nderosh Ndre Mjedën është veç të tjerash të ridimensionosh sistemin e vlerave të identitetit kombëtar, që për fajin tonë, të shqiptarëve, është i brishtë dhe mjerisht edhe “i harrueshëm”.

Kjo më kujton psalmin biblik kur fisi shtegtar rravgonte anës lumenjve të Babilonisë dhe i vari veglat muzikore për të kënduar, në degët e drurëve, për t’u lëkundur nga era.

Të tjerët edhe mund të jenë, siç u shpreha, pa asnjë vetëkënaqje apo cinizmi të llojit barok, “efemeridë”. Por Mjeda nuk është asnjëherë i tillë, ai është një nga shqiptarët më të shquar, një nga karakteret më të ndritshëm, një lloj heroi semantik, i fuqive të koncentruara të intelektit dhe të shpirtit, i shqiptarisë, ku ai u ngjiz si një bardë i një eposi, dikur në shkëlqim dhe sot në terr.

Në panteonin e poetëve kombëtarë Ndre Mjeda nuk është në turmë. Ai është përherë në krye. Ndre Mjeda ka qenë përherë një kryepoet.

Dhe megjithatë për shkak të një paradoksi, banalisht të pashpjegueshëm, për

shkak të një paradoksi që e ka mbështjellë kur ishte i gjallë, por që ka vazhduar edhe pas vdekjes dhe amshimit të tij, Ndre Mjeda shpesh është lënë në hije. Më shpesh heshtin për të. Dhe kjo heshtje është gati sibiline.

Është shkruar shume për Mjedën. Janë botuar libra, studime, janë bërë doktoratura për veprën e Mjedës, janë shpërndarë tituj të kotë shkencorë. Por deri më sot mungon një studim, fjala vjen i llojit të Herald Blumit, që ka shkruar për poetin amerikan Hart Crane etj. studim që në vetvete do të ishte dhe një rizbulim i iluminuar jo vetëm



në aspektin metafizik të poetikës, por sidomos të abstragimeve metaforike të estetikës së madhe.

As jeta e tij nuk dihet plotësisht.

Shqiptarëve u ka munguar përherë një Stefan Zvajg, që do të mund të na profilizonte disa nga paraardhësit e mëdhenj.

Ndre Mjeda u shkollua në Shkodër në fëmijëri. Më pas në edukimin e tij pati ndikim shkrintari jezuit Anton Xanoni (1863-1915) dhe poeti françeskan Leonardo De Martino (1830-1923).

Shoqata e Jezuit e dërgoi djalosin Mjeda jashtë Shqipërisë për studime dhe specializime. Në fillim Mjeda ndenji tre

muaj në pranverën e vitit 1880 në fshatin Cosse-le-Vivien, afër Lavalit, në perëndim të Francës. Më pas ndoqi një kolegji në manastirin Kartuzian të Porta Coelit, në veri të Valencias, në Spanjë, ku studioi për letërsi. Në 1883 e gjejmë në Kroaci, ku studion retorikë, latinisht dhe italisht në një institut në Porto Re, në bregdetin dalmat. Në 1884 deri 1887 studioi në një kolegji që drejtohej atëhere nga Universiteti Gregorian i Romës. Në 1887 u transferua në një tjetër kolegji Gregorian në Chieri, në juglindje të Torinos. Në këto vite Ndre Mjeda filloi të shkruajë poezi shqip. Subjektet e poezive qenë

Mjeda studioi disa vjet në Fakultetin Teologjik të Kolegjit Gregorian të Krakovit në Poloni. Atje u njoh me veprat filologjike të albanologëve Gustav Majer (1850-1900) dhe Holder Pedersen (1867-1953).

Vjersha e Mjedës “Gjuha Shqype” e shkruar në dhjetor 1892 i përkushtohet gjuhëtarit austriak Gustav Majer. Në 1893 poeti ndodhet në Goricia, buzë kufirit italo-sllloven, pas 1 viti sërisht në Porto Re, ku dha mësim filozofinë dhe teologjinë dhe shërbeu si bibliotekar. U emërua profesor i logjikës dhe më pas i metafizikës. Në 1898 në gjirin e jezuitëve në kolegjin e Porto Re shpërtheu një konflikt, mesa duket për lidhjet e tyre me Austro-Hungarinë dhe me Vatikanin. Hollësitë e skandalit nuk dihen me saktësi. Dihet se Mjeda u përfshi në këtë konflikt dhe për këtë gjë u përjashtua, ose dha dorëheqjen atë vit nga Urdhri Jezuit. Në 1899 me ndihmën e të vëllait Lazër Mjeda i cili qe peshkop i Sapës dhe më pas kryepeshkop i Prizrenit dhe kryepeshkop i Shkodrës, sidomos me ndihmën e Preng Doçit (1846-1917), abatin me influencë të Mirditës, që qe edhe vet poet, Mjeda filloi punë si mësues në Vig, në malet e Mirditës. Më pas u shqua në veprimtarinë e shoqërisë letrare “Bashkimi”. Mori pjesë dhe në një shoqatë tjetër letrare “Agimi”. Mjeda ka qenë dhe anëtar i Komisionit Letrare të ngritur në Shkodër më 1 shtator 1916 nën administratën austro-hungareze. Nga viti 1920-1924 ai ishte deputet në Parlamentin Shqiptar. Pas dështimit të Revolucionit të Qershorit të Fan Nolit dhe vendosjes përfundimtare të diktaturës së Zogut, në fund të vitit 1924 ai u tërhoq nga politika dhe punoi thjesht si një famullitar në Kukël, një fshat midis Shkodrës dhe Shëngjinit. Në 1930 qe derisa vdiq mësues i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Kolegjin Jezuit të Shkodrës.

Në këtë shtjellim të shkurtër dhe lakonik të kronologjisë së jetës së Mjedës, të bën përshtypje numri i madh i studimeve në pika të ndryshme të Europës.

Tërë jeta e tij, ndonëse si deputet e njohu edhe ndikimin dhe shijen e rrezikshme të politikës, u përqendrua në fshatin e vogël Kukël që në njëfarë mënyre është sot panteoni i tij i vërtetë, i kujtesës dhe i lavdisë.

Ndërkaq analiza e poemave të tij është një analizë më tepër shpjeguese dhe komentuese. Sepse është tepër e vështirë të krijosh një përfytyrim dhe një sintezë të denjë dhe absolute për Ndre Mjedën.

Le të marrim poemën e tij që përmban letrat kredenciale të tij të shpirtit, “Vaji i bilbilit”.

Kjo poemë e famshme mbas kaq vitesh nuk e ka humbur aspak plotfuqishmërinë e idesë së lirisë universale.

Mjeda thotë vargjet tronditëse për bil-

bilin:

“Kafaz ke qiellin,  
Epshin pengim.”

Është e njohur në poezinë evropiane “Ode bilbilin” të John Keats. Këtë poezi poeti i prekur nga tuberkulozi, i varfër dhe i pafat në dashuri, e thuri në një kopsht të Hampsteadit, kur ishte 23 vjeç, në një rënë nga netët e muajit prill të vitit 1819.

Keats tregon se dëgjoji në imagjinatë bilbilin e përjetshëm të Ovidit dhe Shekspirin. Ai e shkroi poezinë për bilbilin për të krijuar një simbol që tejkalon kohërat.

Jorge Luis Borges që i ka kushtuar një ese të mrekullueshme, pikërisht poezisë së famshme të Keats thotë se Keats nëpërmjet miliona bilbilëve konkretë dhe të gjallë, preferoi përjetësinë e një bilbili platonik, që përfaqëson dhe simbolizon gjithçka. Sa herë e kam lexuar poemën e Mjedës për bilbilin, kam parë jo vetëm ndryshimin konceptual midis poezisë që ekziston në të gjitha antologjitë botërore të Keats, por pa asnjë fije kompleksi të nënvleftësimit, apo dhe të inferioritetit, e kam ndjerë dhe e them me bindje se poema e Mjedës për bilbilin, bashkëkohëse me atë të Keats, është më e fuqishme, më përgjithësuese dhe sigurisht më universale.

Mjeda në këtë poemë ka në rrëfimin profetik:

“Bylbyl, ky shekull orë e ças ndrohet:  
Bijnë poshtë të naltit, i vogli çohet;  
Edhe natyra po don me ndrrue:  
Fillo me gëzue.”

Pra Mjeda i shpërthen shkretëtirat e errëta të metafizikës dhe bilbili i tij shndërrit me një transiguracion drite gjithçka.

Ideja kryesore është Liria. Liria dhe vetëm Liria. Mjeda është poeti i madh i Lirisë. Mjeda është femja, udhëtari dhe mendimtari i Lirisë. Ai e ka kuptuar, si pak kush shqiptarë në kohëra se Liria është gjëja më e munguar për kombin shqiptar.

Mungesa e Lirisë e primitivizon përherë këtë komb. Vetëm Liria e ngjall. Vetëm Liria e natyralizon identitetin e vërtetë. Vetëm Liria e përjetëson kauzën. Vetëm Liria e garanton përherë Lirinë.

Në poemat e shquara të tij Mjeda kërkon dëshmi të Lirisë tek paraardhësit, tek historia e harruar e ilirëve, tek mesjeta shqiptare e Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe tek shqiptarët e trohitur dhe shpesh shumë të plogët të kohës së tij.

Vetëm Mjeda është i pari poet që ka shkruar me nderim për mbretëreshën Teuta dy herë në poemat e tij.

Tek poema e njohur “Iliria dhe Epiri” janë dhjetë strofa ku ai ka skalitur heroizmin e ilirëve dhe të mbretëreshës Teuta. Ai e përshkruan Teutën si një Amazonë të historisë dhe të mitit e cila “mbështetur në ushtritë e veta, pa e ulur gjunin, para të dërguarve të Romës, me faqe të rreptë i tha Romës së madhe: Mos prit çfarë kërkon prej ilirëve.”

Po nuk mjaftohet vetëm me këtë pikurë heroike.

Tek poema “Lisus” Mjeda e përshkruan me vargje të mrekullueshme përsëri monumentalitetin historik dhe tharmin etik të Teutës mbretërore, nuk di deri më sot asnjë poet shqiptar t’i ketë kushtuar kaq shumë vargje Teutës si Mjeda.

Poeti kërkon të evokojë.

Ai zëvendëson në imagjinatë tërë mungesat dhe boshllëqet e shekujve. Pa dyshim kryevepra e Mjedës e krejt poezisë shqipe dhe një njëkohësisht poemë e mrekullueshme në nivel evropian është poema e quajtur “Liria”.

Në këtë poemë Mjeda duket sikur vikat, sikur klith me gjoksin e shekujve:

“O shqype, o zogjtë e maleve, kallxon  
A shndritë rreze lirije mb’ato maja?  
Mbi bjeshkë të thepisuna e nd’ograjë  
Ku del gurra e gjimon përmallshëm  
kroni?”

Në pjesën e dytë të poemës Mjeda bën një apoteozë të lirisë amerikane.

Ai e njeh dhe entuziazmohet nga Revolucioni Amerikan i Lirisë, që u zhvillua kundër shkëputjes së Amerikës nga sundimi kolonial i Anglisë. Ai flet për fushat ku rrjedh lumi i Misisipit.

Ai evokon emrin e Gjergj Uashingtonit. Mjeda thotë se “Ëashingtoni na

teozën amerikane.

Ai thotë:

“Ty të kjofta falë, o dritë, ama e mbrodhsimit

Ti dave terrin e egërsis, e tine  
E lakmuesja e gjith dhenave latine  
Amerikën e pshtove prej robnimit!”

Në pjesën e pestë të poemës poeti shpërthen (një nga shpërthimet poetike më të mëdha të kohërave) për kontrastin e frikshëm të robërisë së shqiptarëve, në raport me lirinë.

Është pikërisht Mjeda që ka thënë këto vargje të pashlyeshme, të tmerrshme, asnjëherë të tjetërsueshme, kurrë të harrueshme:

“Lirin e keni ju! Na hekra kemi.

Na terr e mjergull, deri në dit ma të vona;

Na pa emen kërkund, pa atdhe, na jemi  
Shërbëtorët e të huejve nëpër vende  
tona!”

Poeti si Demijurg i Lirisë nuk ka frikë

farë pa frikë Lirinë.

Një njeriu të zakonshëm mund t’i lejohet pikëllimi fatalist, zvetëni.

Por një poeti si Mjeda nuk i lejohet asnjë që nuk ka të bëjë me plotfuqishmërinë e Lirisë. Pra edhe për vetë shqiptarët. Ndaj soneti i fundit i kësaj poeme të habitshme është:

“Por nuk u shuejt edhe, jo, Shqyptaria:  
Lodhun prej hekrash qi mizori i njeti,  
Lodhun prej terri ku robnimi e qiti,  
Shpreson me e zgjua fluturim mëni.

E kqyrë: ndër male po përhapet  
shkëndija

E lirim t’Atdheut: fshehtas shëtit

Kësollë për kësollë rreth buneve e soditi,

Frymë të re tui shprazun për gjithkanna, hija!

E Skanderbegut që ndër djepa rrisin

Nanat e Hotit djelmin ushtore,

E idhnm n’annikun nëpër gjij qisin.

E Nalt ndër maje, bukuri mbretnore,  
Hapi flatrat e mnëshme qi përshndrisin,

Me thoj t’harkuem Shqypeja Arbënore!”

Ky është soneti epokal i ringjalljes dhe mua më kujtohet çka shkruar i lumi Pholothee O’Neddy: “Liria, ky emër i tmerrshëm, i shkruar në karrocën e stuhive!”

Ndre Mjeda është poet i madh, i një rendi të lartë estetik.

Poemat e tij me sonete janë arritje të pakrahasueshme. Në këtë pikë Mjeda jo vetëm që shkëlqen, por ngrihet mb tërë poetët e tjerë. Mjeda ka shkruar një shqipe të përsosur në vargëzim. Kjo është gjuha e tij e poetikës. Një gjuhë e paimitueshme nga askush.

Mjerisht, Ajme, që Mjeda është një poet gati i papërkthyeshem në gjuhët e tjera evropiane.

Gjithë jetën time e kam adhurar Mjedën. Për nder të tij korpusit tim poetik i vura një emër të thjeshtë latin “Miscellanea”, që do të thotë Përzgjedhje, për të krijuar një tingëllim të ngjashëm dhe grishës me titullin e mrekullueshem latin, “Juvenilja, që do të thotë Rinia, ose Djalëria.

Mjeda i ka të gjitha atributet por dhe vështirësitë për të tërhequr vëmendjen e tërë shqiptarëve por dhe shteteve të shquar.

herë lexoj Mjedën më kujtohet se ç’ka shkruar Ëhiteman: “There is that I in me – I do not knoë ëhat it is – but I knoë it is me”.

Që në shqip do të thotë: “Është diçka tek unë – Nuk e di se çfarë është- por e do që është.”

Tek ne shqiptarët është gjithmonë Mjeda.

Edhe atëherë kur nuk e dimë që ai nuk është. Por ja që ai është dhe do të jetë.

Mjeda si Poet i Lirisë nuk do të harrohet, veçse nese ne do të harrojmë vetëveten. Amen!



thërret”. Atëherë populli amerikan u ngrit për të fituar lirinë. Vajti tërë Amerika mbas këtij zëri që e thirri për nderin e lirisë. Dhe “luani i Amerikës e mudi kuçedrën e Anglisë”.

Liria u ndje te punëtori që vuan në vapën e zhegut, liria u ndje në Labrador tek Virgjina dhe Neë Jorgu, syni i tregut”. Mjeda thotë “Të lumtë, o Ëashington”. Dhe liria duke thërritur në Filadelfia koncentrohet në sentencën mjediane “Amerikën e zhgon (e qeveris) Amerikani”.

Në pjesën e tretë dhe të katërt të poemës Mjeda e përshndrit përsëri apo-

asnjëherë ta thotë të vërtetën.

Kjo ka qenë shpesh në shekuj historia e shqiptarëve: “shërbëtorë të të huajve në vendin tonë”. Po pse dreqin ndodh kështu? Pse ka ndodhur kështu? Dhe pse ende mund të ndodhë kështu? Duket sikur ndjenja e pezmit na çon në mungesën e një perspektive. Duket se shpresa zhbëhet, për të humbur përgjithmonë. Duket sikur shqiptarët nuk kanë kauzë dhe asnjë projekt mendor të vërtetë. Të torturuar për mercenarizmin, servilizmin, prej korrupsionit, të krijuar nga klasat politike në shekuj, shqiptarët e kanë të vështirë të dashurojnë me afsh dhe

# N JËMBËDHJETË VJET. SHTETI I KOSOVES DHE MUNDËSIA PËR SHQIPËRINË E BASHKUAR

Në 17 Shkurt të 2008, Kosova deklaroi në mënyrë të njëanshme Pavarësinë e saj nga Serbia. Kjo ngjarje ishte një fitore e madhe për shqiptarët e Kosovës, luftërat e të cilëve nuk pushuan kurrë ndër vite derisa me ndihmën e SHBA dhe NATO-s, së bashku me UÇK, arritën në këtë ngjarje të madhe pavarësisht shumë viktimave, reprezaljeve nga ana e ushtrisë serbe. Njohja zyrtare si shtet sovran i Kosovës, me 17 Shkurt 2008, u bë pas njohjes diplomatike e zyrtare të fituar dhe të pranuar nga 113 shtete, anëtare të OKB.

Megjithatë, Serbia nuk e njohu dhe nuk e njeh ende pavarësinë dhe shtetin sovran të Kosovës, me gjithë Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013, për të pranuar institucionet e reja në Kosovë. Megjithëse Serbia e njeh administrimin e territorit të Kosovës nga ana e qeverisë së zgjedhur kosovare, ajo vazhdon ta pretendojë Shtetin e Kosovës si "Krahinë Autonome të Kosovës dhe Metohisë".

Shqipëria, si vendi amë i shqiptarëve kudo që ndodhen e ka përkrahur fuqimisht Kosovën e pavarur dhe sovranë dhe ka dhënë ndihmesën e saj në çdo rast duke respektuar ligjet ndërkombëtare në fuqi në sinkronizim të plotë me vullnetin e SHBA-s dhe të BE-s. Çdokush, që është shqiptar i vërtetë e sheh me gëzim dhe shpresë, që më në fund shqiptarët e Kosovës të ndarë nga trunghi i territoreve shqiptare me dhunë zyrtarisht nga Marrëveshja e Ambasadorëve më 1913 jetojnë të lirë dhe të pavarura nga pushtimi 100 vjeçar serb, i cili solli shumë fatkeqësi, pabarazi, krime dhe një urrejtje midis popujve, e cila nuk u shua as kur propaganda e rreme e Jugosllavisë,

Gjithmonë shqiptarët e Shqipërisë dëshirojnë, që së bashku me shqiptarët e Kosovës të integrohen në BE dhe të kenë liri hyrje e dalje në çdo vend të BE-së, gjë të cilën, shqiptarët e Kosovës ende nuk e kanë. Por shumë shpejt do ta kenë edhe atë nëse BE-ja do të kuptojë se faktori shqiptar është një nga faktorët më të rëndësishëm në gadishullin Ilirik qoftë për sa i përket Paqes, qoftë për sa i përket respektimit reciprok ndaj popujve dhe historisë së shqiptarëve në Iliri, që dikur quheshin Arbër dhe Epirit.

Përplasja gjeopolitike midis Rusisë dhe SHBA, midis Rusisë dhe BE-së për sa i përket gadishullit Ilirik do të jetë në favorin e SHBA, sepse SHBA është i vetmi shtet që kërkon një Faktor të fortë shqiptar në këtë pjesë të Evropës.

Aspiratat e Shqipërisë për t'u integruar në BE dhe së bashku me të edhe Kosova, do të na japin mundësinë për një bashkim të ardhshëm jo vetëm virtual të faktorit shqiptar në këtë pjesë të Evropës, por edhe real, sepse dihet një Shqipëri e Bash-

kuar do të jetë një mjedis nëpërmjet të cilit paqja në gadishullin Ilirik është më e siguruar; sidoqoftë nuk përjashtohen edhe mundësi të tjera, që mund të propozohen nga BE-ja, si një Konfederatë Perëndimore në Iliri, por e rëndësishme është bashkimi i trojeve shqiptare të copëtuara 100 e ca vite më parë.

Bashkimi dhe integrimi i të dy vendeve në një, do të ketë përparësi sepse dihet që vendet e vogla kanë mundësi të pakta punësimi dhe rritjeje ekonomike. Pavarësisht, se Shqipëria ka një rritje ekonomike të mirë këto tre vitet e fundit afër 4.2%, largimi i rinisë për në BE ashtu siç po



ndodh edhe në vendet e tjera të vogla të këtij gadishulli, si në Kosovë, Maqedoni, Kroaci, Mal i Zi, madje dhe në vendet që janë në BE si Bullgaria dhe Rumania- të krijojnë idenë se bërja e një tregu të madh pakëson emigracionin.

Emri Kosovë mund të ndryshohet në emrin e saj fillestar, Dardani, ide të cilën e ka shprehur dhe Ibrahim Rugova. Problemi tjetër i madh sidomos në Kosovë, ai i religjionit islam me anë të të cilët vendet e lindjes si Turqia dhe Arabia Saudite e kërkojnë Kosovën të mbetet në lindje një lloj si statusi vëzhgues në Konferencën islamike, ashtu që dhe Shqipëria është anëtar e saj, mund të jetë i rrezikshëm për popullsinë.

Dihejt që çlirimi i Kosovës nga serbët nuk ka përfunduar plotësisht, po të shohim Preshevën, Bujanovcin dhe sigurisht Metohinë ose Dukagjinin e djeshëm. Shpresojmë që integrimi dhe zbutja e mllëve dhe armiqtësisë shekullore midis sllavëve ortodoksë dhe shqiptarëve myslimanë të Kosovës dhe Metohisë, me kalimin e brezave do të afrojnë këto bashkësi dhe popullata, të cilat për shumë së

dy shekuj kanë jetuar në armiqësi, madje njihet historia që nga koha e Gjeto Basho Mujit dhe Halilit, ngjarje që kanë ndodhur nga shekulli i XVI.

## Pak histori

Po të shohim shkurtimisht historinë e Kosovës, duket qartë lidhja e ngushtë me truallin amë Shqipërinë apo Arbërinë e dikurshme para pushtimit Osman. Dihet që emri Kosovë u vendos pas luftës së vitit 1389, në të cilën koalicioni ortodoks i serbëve, bullgarëve dhe Princave shqiptarë të famshëm si Gjon (Palë) Kastrioti, gjyshi i Gjergj Kastriotit, Theodhori i I Muzaka, Mëhill Nikollë Kopiliqi, Dhim-

ose sllavët e Vollgës) dhe në vitin 850, çimentuan kulturën bizantine dhe absorbuan pjesërisht popullatat ilire të Dardanisë, të Arbërisë dhe të Epirit.

Në shekullin XII, Stefan Nemanja, një arbër i sllavizuar sundoi Provincën e Dardanisë, që sot quhet Kosovë, dhe Stefan Dushani bëri kryeqytet Prizrenin duke krijuar Perandorinë Serbe që qëndroi përreth një shekulli e pak, ku dhe u themelua shtëpia princërore e Brankovicëve, deri në vitin 1371.

Deri në vitin 1455 arbit e Kosovës dhe të Veriut të Shqipërisë së sotme, krijuan Principatën e Dukagjinëve dhe të Kastriotëve, të cilët luftuan kundër osmanëve. Pastaj nga viti 1455-deri më 1912, Kosova mbeti pjesë e Perandorisë Osmane, si pjesë e vilajetit të Rumelisë dhe përfshinte territorin e Kosovës së sotme, sektorët e Sanxhakut, Malin e Zi dhe Kukësin, deri në lindje përfshi Shkupin si Kryeqytet të këtij vilajeti.

Popullata sipas historianit Frederik Ancombe ishte heterogjene, por në kohën e sundimit turk një pjesë e madhe e popullatës u islamizua, një pjesë sidomos në fushat e Kosovës erdhën bujkrobër nga Anadoli, një pjesë emigroi në Itali, dhe një pjesë u sllavizuan për shkak të një Urdhri të Sulltan Mehmetit të II, që pronat e Kishave ortodokse nuk do të preken nëse do të paguajnë haraçin përkatës dhe nëse do të lejojnë ushtrinë osmane të kalojë aty nëse e sheh të nevojshme. Ata u quajtën shkie.

Në 1766 osmanët anuluan dhe prishën Patriarkanën ortodokse të Pejës duke vendosur kufizim ndaj popullatës jo islame. Kjo shkaktoi islamizimin e madh të arbërve të asaj kohe, të cilët gradualisht u quajtën shqiptarë, emër të cilin e morën edhe arbit shqipfolës të krishterë katolike dhe ata që mbetën ortodoksë. Në këtë mënyrë shqiptarët pranuan sovranitetin e osmanëve dhe shumë shqiptarë morën tituj dhe funksione në Perandorinë osmane, në të cilën drejtuan rreth 37 vezirë, krye-vezirë e pashallarë.

Shekulli i XIX zgjoi nacionalizmin, sidomos pas Lidhjes së Prizrenit armiqtëria serbo-shqiptare u acarua shumë kur Traktati i Shën Stefanit i a kalonte Kosovën dhe krahinat shqiptare të tjera përreth, nën sundimin serb, në një kohë kur popullata shqiptare ishte një lloj sa popullata serbe sipas regjistrimit të asaj kohe, të viteve 1867.

Në 1912 konflikti kundër Perandorisë Osmane dhe kundër serbëve u ashpërsua, madje një pjesë e luftëtarëve shqiptarë kërcënuan turqit e rinj që do të marshonin deri në Selanik dhe të rivendosnin Sulltan Abdyl-Hamitin përsëri, nëse nuk krijohej një shtet shqiptar jashtë

# 70 vite hire dhe bekime në shërbim të dashurisë

**“ZOTI ËSHTË BARIU IM, ASGJË NUK MË MUNGON”**

Kur jemi të veshur me Dashurinë e Zotit vërtet nuk na mungon asgjë. Dashuria e Zotit për **bijtë** e Tij është e pakufishme. Ajo na ofrohet në jetë në **forma** nga më të **ndryshme**. Na afrohet përmes **prindërve**, të afërmeve e te tjera.

Dashurinë dhe përkujdesjen Zoti e sjell në jetën tonë edhe nëpërmjet Kishës, e cila merr jetë nga Provania Hyjnore dhe struktura saj **tokësore**. Ne, si grigjë e Zotit e kemi **gjithmonë të pranishme dashurinë, përkujdesjen dhe këshillën e Bariut tonë të Mirë, në rastin konkret të shkëlqesisë së tij Monsignor Angelo Massafres. Në këto ditë festë për Kishën, ne si grigjë e besuar në duart e tij me fjalë zemre i shprehim falënderimet për dashurinë, përkujdesjen dhe sakrificën e dhuruar për shumë e shumë vite të mbushura me plotë trazira dhe rreziqe.**

**Shkëlqesi të falënderojmë për dashurinë e mbi të gjitha për vigjilencën e frymëzuar nga Shpirti Shenjë për të qëndruar mbi grigjën tënde duke e mbrojtur nga grabitqarët që kjo kohe solli. Të falënderojmë për forcën dhe durimin, të cilën ke treguar dhe tregon për tu përballur me çdo rrezik (trazirat politike, gjakmarrjen, drogën, abortin, divorcin e të tjera), që ju ka afruar grigjës tënde. Hired dhe Bekimet janë të**

**pafundme, që Zoti na i dhuroj në ato moment, që shkele token tënde të munguar prej shekujsh përtej deti.**

*Dua të theksoj fjalët e Presidentit Meta*



**,me rastin e marrjes së urdhrit “Nënë Tereza”, “Zbrite në tokën Shqiptare duke mbajtur amanetin e të parëve tuaj, kur u larguan nga kjo tokë nga pushtuesit Otoman. U ktheve në tokën tënde si birë i kësaj toke, për ta veshur me dashuri dhe përkujdesje”.**

*Faleminderit Bariu ynë i mirë.*

**Shkëlqesia së tij Monsignor Angelo Massafres** u lind më 23 mars 1949 në San Marzano di San Giuseppe , një komunitet historik shqiptar në Puglia.

Ai u shugurua si prift i Urdhrit Françeskan më 21 shtator 1974 nga Arqipeshkvi Francesco Minerva.

Me ardhjen e demokracisë është nder të parët që kthehet në tokën Shqiptare.

Më 7 dhjetor 1996, Papa Gjon Pali II e emëroi atë Ipeshkëv të Rrëshenit dhe e shuguron më 6 Janar në bazilikën e Vatikanit. Më 28 mars 1998 ai u emërua Arqipeshkëv i Shkodrës dhe më 25 janar 2005 , pas riorganizimit të Shqipërisë, u bë Arqipeshkëv i Dio-

këvi i dioqezës Shkodër – Pult, Monsignor Angelo Massafra mbushi 70 vjet. Me këtë rast në katedralen “Shën Shtjefni” në Shkodër, më 23 Mars u kremtua Mesha e Shenjtë, për 70-vjetorin e lindjes të Arqipeshkëvit, në praninë edhe të Nuncit apostolik në Shqipëri Çarls Braun.

Në predikimin e tij Arqipeshkëvi Massafra, pas falënderimeve ndaj Zotit e ftoi grigjën e tij të ketë një jetë, të cilën duhet ta vlerësojmë si dhuratë e dhanur nga Zoti. Ai u shpreh, se fenomenet negative nuk duhet të na mposhtin në jetën tonë.

Në përfundimin e Meshës, Nuncit apostolik në Shqipëri, Çarls Braun, përcolli mesazhin e Atit të shenjtë, Papa Françesku, me rastin e 70 vjetorit të lindjes së Arqipeshkëvi Massafra .

Në këtë 70 vjetor të lindjes Arqipeshkëvi Massafra ka marrë shumë urime jo vetëm nga besimtarët por edhe më gjerë duke e uruar edhe për misionin e tij në krye të dioqezës Shkodër-Pult.

Me këtë rast, më datën 23 – 24 mars 2019 u zhvilluan disa veprimtari të organizuar mjaftë mirë nga arqipeshkëvia, famullia e Shën Shtjefnit të udhëhequr nga famullitari i saj, Don Vlash Palaj, në bashkëpunim me Motrat Stigmatine.

Duke udhëtuar me ju Shkëlqesi gjatë vizitës Baritore takojmë buqeta të shumta lulesh, të cilat janë shenjë e falënderimit, që grigja e besuar në duart tuaja i dhuron para Zotit që të zgjedhi të na dhurojë dashurinë e Tij përmes duarve tuaja.

Faleminderit Bariu ynë i mirë!

Redaksia e gazetës “Dukagjini”, ju uron: “Ta gëzoni 70 vjetorin e lindjes, me plote shëndet e mirësi në detyrën tuaj të shenjtë!”

**Nga Roza Pjetri**

◀ Serbisë.

Sidoqoftë shpallja e Pavarësisë nga ismail Bej Qemali, pjesëmarrja e gati 20 përfaqësuesve nga Kosova e Metohija në Vlorë precipitoi ngjarjet dhe në 1913 Konferenca e Ambasadorëve në Londër vendosi përfundimisht ndarjen e Kosovës nga Shqipëria dhe kalimin e saj nën Mbretërinë e Serbisë.

Filluan masakrat kundër shqiptarëve dhe ngjarjet e luftës së parë botërore u vranë shumë shqiptarë të Kosovës dhe u larguan me mijëra shqiptarë për në Turqi, rreth 240 000 shqiptarë deri në fillimin e luftës së dytë botërore.

Pas vitit 1945, Jugosllavia e përfshiu si Krahinë Autonome - Kosovën dhe Metohinë, dhe i vendosi një flamur si ai shqiptar, por me yllin me pesë cepa anash.

Me kalimin e viteve, Politika e Titos zbuti qëndrimin ndaj shqiptarëve, ndoshta edhe nga premtimi i mbajtur në Konferencën e Avnoi dhe në bisedë me Enver Hoxhën më 1946, të cilit i tha pak a shumë se... nuk mund ta bashkoj Shqipërinë me Kosovën, se nuk na lenë serbët, por do tu jap autonomi të zgjeruar... Dhe kështu ndodhi.

Në 1974 Kosovës i u dha Autonomi e zgjeruar, iu dha një nën President dhe anëtarësim në drejtimin kolektiv të Jugosllavisë, u hap Universiteti në Prishtinë.

Në 1981 u ashpërsua konflikti përsëri pas vdekjes së Titos, në të cilët shqiptarët kërkonin Republike të shtatë, dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, por politikisht z. Mahmut Bakalli tha që:... “le të bashkohet Shqipëria me ne në një Republikë të shtatë dhe jo të bashkohemi me Shqipërinë...” Kryengritja u shtyp me ashpërsi.

Në 1989 Millosheviçi, me rastin e 600 vjetorit të betejës së Fushë Kosovës, reduktoi statusin e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë duke shkaktuar kështu rritjen e revoltës dhe fillimin e luftës shqiptarë të Kosovës kundër serbëve. Prishja e Jugosllavisë nxiti nacionalizmin kudo, edhe në Kosovë.

Në Korrik 1990 shqiptarët e Kosovës proklamuan Republikën e Kosovës dhe Ibrahim Rugova më 1992 u zgjedh President.

Në 1996 u formua Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe vazhdoi lufta në Kosovë, e cila rezultoi me Masakrën e Raçak-ut

qesësë Metropolitane Shkodër - Pult. Drejton Konferencën Ipeshkvnore të Shqipërisë duke u lutur e punuar me këmbëngulje që strukturat e saj të funksionojnë më së miri në shërbim të shpalljes së Lajmit të Mirë.

Me datën 23 Mars 2019, Arqipesh-

në 1998. Në Mars u mbajt Konferenca e Rambujesë dhe Marrëveshja e saj, e cila kërkoi rikthimin e Autonomisë së Kosovës dhe vendosjen e NATO-s në Kosovë.

Midis 24 Marsit 1999- deri në 10 Qershor 1999 NATO ndërhyri për shkak se Millosheviçi bëri reprezalje të madhe në Kosovë duke larguar nga Kosova rreth 400 000 shqiptarë, të cilët bujtën në Shqipëri. Me 12 Qershor 1999, u futën trupat tokësore të NATO-s në territorin e Kosovës dhe Kosova përfundimisht u çlirua nga pushtimi shekullor serb. Kështu, data e çlirimit të Kosovës nga pushtimi serb, është data 12 qershor 1999.

\*\*\*

Rezoluta 1244 siguroi Kosovës autonominë.

Në 2006 Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 dhe bisedimet e drejtuara nga Matii Ahtisaari progresuan.

Në Shkurt 2007 Ahtisaari propozoi Draftin për një Pavarësi të Mbikëqyrur të Kosovës.

Në 17 Shkurt 2008 Kosova deklaroi Pavarësinë nga Serbia. Në 4 Nëntor 2018, 113 shtete njohin Pavarësinë e Kosovës.

Republika e Kosovës shumë shpejt u njoh dhe u bë anëtare e FMN, dhe Bankës Botërore.

Mos njohja nga ana e Serbisë ka krijuar precedent në ardhmërinë e Kosovës pikërisht edhe nga skepticizmi i BE-s dhe i Rusisë, por përkrahja e fuqishme nga ana e SHBA-s, po ndihmon Kosovën të eci përpara, duke pritur edhe heqjen e vizave dhe zgjidhjen e problemeve me anë të kompromiseve dhe bashkëpunimit të fortë me faktorin ndërkombëtar dhe sidomos me SHBA-n dhe BE-n.

Shqipëria gëzohet dhe inkurajon Kosovën dhe do të jetë përkrahësja më e fuqishme e saj duke ditur se shqiptarët e Kosovës dhe kudo që janë në trojet përreth Shqipërisë mëmë, presin që të integrohen në BE, por edhe të shpësojnë që të bashkohen në ato forma, që do të pranohen nga SHBA-ja dhe BE-ja.

\*\*\*

Republika e Kosovës GËZUAR PAVARËSINË!

**Nga Ndue SANAJ**

# CURRAJ I EPËR VETËZBULOI VIRGJËRINË DHE HIRET E VETA RREZATUESE ALPINE

(vijon nga numri 184)

Nuk milet tambël ma i mirë prej cice se i deleve që kullostin bjeshkëve të Currajve, i cili nuk zihej pa ujë, ndërsa kosi pritej me thikë, si djathi i njomë. Edhe tlyni, kosi i kulluar, dhalla, mishovina ishin të mëlmyeshmet, të lehta, të lakmueshme dhe tregoheshin duke thënë: Ah, si tlyen, kos apo djathë Currajsh. Kudo në Dukagjin e më gjerë recitohej alegoria *“Curraj të epër hanë kos të vjetër”*.

Kosi në vjeshtë kullohej, kripej dhe futej në sheka druri, ose tinarë të veçantë disa kuintal izolohej dhe përdorej gjatë dimrit. Buka e misrit e gatuar në vatër e shoqëruar me këtë lloj shëlline të kullume apo kos të vjetër është armë dhe shije e pa rezistueshme e shëndetshme po aq sa bjeshka që e ka dhuruar. Sot koha ka ndryshuar në mënyrë perpendikulare prandaj kreshtat pyesin shoqja –shoqen; “Mos vallë bishat i qitën fare tufat e këtyre bjeshkëve që mbetën pa këmbë bagëtie?!”

Po kostarët ku humbën që lanë livadhet në mjerim e shëmtirë si njeri të panjeri, të pastrehë, të pa larë, pa krehur e pa rruar? Currajt e Epër mbanin në mënyrë shembullore bjeshkë dhe vrri, ndërsa nëna natyrë ua shpërblente bujarisht me dhurata hyjnore shëndet, shtatëlartësi hirëplote, jetëgjatësi, inteligjencë dhe gene të fuqishëm. Në ato varre gjenden të murosur kërricat e vjetër të këtij fisi që jetuan mbi një shekull, pa ditë se çfarë është mjeku, spitali as barnat, madje jo pak prej tyre nuk dolën kurrë nga kopshti i bekuar që ju bëri dhuratë perëndia. Në ato varre, sot të mbuluar nga bari dhe fieri, shkuan para kohë shumë djem njomëzak dhe burra të shytuar me kokërr nga pushka vrastare. Nga këto varre të mbytur në dhimbje e lot fatkeqësisht u ringjall kjo plagë e vjetër e kohës arkaike duke rikthyer së bashku me lirinë e bjerrë në diktaturë. Hisja tjetër a atyre varreve i përket ish gjysmës tjetër më të bukur. Të shumtat e ndjera patën bukurinë e natyrës së virgjër, shijen e verës, shkathtësinë e fluturës dhe freskinë e fladit së mëngjesit. Zemrat e tyre kishin bardhësinë e borës dhe ngrohtësinë e diellit, shpirti i tyre kishte mjaltin dhe thumbin e bletës, krahët e pëllumbit dhe qyqes, personifikim virtytit. Ato ishin shëmbëlltyrë e nënës së dashur e memece, sokoleshës dhe hirushes mëkatore, personifikim i kohës fytyrëvrazhdë kur jetuan. Filimi i vërtetë i popullimit të këtij fshati është vështirë të konfirmohet si për shumicën e gjithë fshatrave që përfshinë territorin i gjerë Malësisë në tërësi (*Malësia = Malësi e Madhe + Malësia Dukagjini + Malësi e Gjakovës*). Në vitin 1908, gjatë një ekspedite që bëri në Curraj të Epër, Baroni dhe studiuesi shumë dimensional Franc Nopça, gjeti një spate bronci që i përkiste tipit iliro-dalmat që na le të kuptojmë se kjo luginë ka qënë populluar që herët.

Popullata e Currajve të Epër janë pasues të fisit mesjetar të Nikajve (Nikë –Meksh-Bibë) degë e Mark Bibës vëlla me Lek Bibën dhe Kol Bibën. Kjo degë u rrit dhe u shumua shpejt dhe u zgjerua fillimisht në Curraj të Poshtëm pastaj u ngjiti lart në Curraj të Epër rreth vitit 1634-1671<sup>1</sup> Në



atë bjeshkë jetonin Pjaje(eshët) e Mavriqit, anas të shumë vjetër, ndoshta tepriçë thrako-ilire Historia deri më sot nuk ka mundur të përcaktojë se kur Mavriqët ishin vendosur në këtë luginë. Ajo që dihet qartësisht është se në Curraj ka patur një seli Arqipeshkvale e quajtur Kisha e Luzajës që i përket kësaj popullate por të dëbuar forcërisht prej këtu dhe lënë si kujtim pas vetit varrezat e mavriqit. Fat

1 Dodë Progni, Zef Deda “Nikaj Merturi vështrim historik” Shtypur në Shypshkronjën “Shtjefni” viti 2003, fq 162-45. Ibrahim Kadri Malaj “Tropoja” SH.BDardania Tiranë 2003. fq.377

tjetër patën kapitët edhe këta anas, 25 shtëpi në dy mëhallë, të struktur në qoshe ku gjenden akoma edhe sot në statusin e një minorance vasale të bijve të Nikës. Pjesa tjetër u vendos në Malësi të Madhe (Mbi Shkodër) dhe u konvertua duke humbur kontaktet dhe lidhjet me fisin

kagjinit<sup>3</sup>. Gjerësisht sipas traditës popullore dhe pemës gjenealogjike Nikaj janë fis vëlla me Daket e Pukës, me Krasniqen dhe Vasejoviçet e Malit të zi<sup>4</sup>. Ami Bue duke ju referuar një tradite tjetër na jep mbretin e fundit sllav të Dalmacisë(D) si baba i Pipos Hotos, Vasos dhe Krasos, kryetarë të fiseve Piperi, Hoti, Vasejoviçi dhe Krasniqe. Ka edhe një traditë tjetër më pak të besueshme që i referohet vitit 1898 nga LE(CCLX) që jep kate por tre vëllezër Nika Krasoviçi dhe Vasoviçi. Ajo së cilës i referohet (D)dhe na përshkruan Gegë Lazrin kryetar të fisit të Hotit, babanë e Nikut(kryetar i fisit të Nikajve?)nga të cilët Krasa, kryetar i fisit të Krasniqes duhet të jenë birë e vëlla ose i ardhur prej tij.<sup>5</sup> Përfundimisht mbi-zotëron artikulli tregimtarë se një bari Krastos me emrin Nika, atlasi i fisit të Nikajve, ardhur në vendbanimin aktual duhet të ketë nënë, birë ose pasardhës i fisit të Gegë Lazrit, kryetar i fisit të Hotit dhe baba ose vëllai i fisit të Gashit. Konvertimi Krasniqes solli një thyerje të fortë tektonikë, në besim ndonëse asnjëherë Nikajt dhe Krasniqja nuk mohohet

amë. Kapitët i përkasin derës së Vajushëve<sup>2</sup> të cilët banojnë aty që prej kush e di sa e sa motesh përpara Currajve.

Currajt, si gjymtyrë organike e Nikajve ,bëjnë pjesë në grupin e katër fiseve të mëdha të Dukagjinit të sipërm, politikisht dhe historikisht ka shkuar më shumë më Malësinë e Gjakovës (D .Bald ), me të cilën e bashkoi administrata turke per ta shkëputur nga blloku katolik i Du-

jnë vllazninë e gjakut dhe rrugëtimin nga Bosnjia, rrethinat e Podgoricës, në Reç të Shkodrës, Dushaj ku më pas u ngulitën dhe u bënë me vatan aty ku gjenden sot.

Nikaj me Merturin nuk kanë asnjë pikë kontakti gjenealogjik, janë fqinjë të lidhur me qindra krushqi tradita kanun e besim, alet të përhershëm në sfidat arkaike

3 Xhuzepe Valentinit “E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare” po aty

4 Xhuzepe Valentinit “E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare” po aty

5 At Xhuzepe Valentinit “E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare”Botimi pare Tiranë 2007, fq.327

2 At Xhuzepe Valentinit “E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare”Botimi pare Tiranë 2007, fq.370



me Gash e Grsnique dhe Shalë Shosh. Tashmë është provuar se një familje fuqishme e Gjakovës dhe pinjollit i saj i shquar Bajram Curri rrjedhë nga fshati Curraj. Ka dy versione së familja Curri dhe gjithë Currajt këtë emër e morën për shkak të terrenit shkëmbor me Curra njeri variant dhe i dyti ky emër u mbeti nga nënëlokja Curra e cila pati humbur njërin vesh. Përgjatë bregut Perëndimor të lumit shtrihen lagjet Prepepaj, Ndre-vataj, Mrishaj, Prebibajt, në krahun tjetër shtrihen Qokajt, Nikbibajt, Malndrejat, dhe Gecajt e Kuq.

## AUTOMOBILI DITËLINDJEN E 359 –TË E FESTON NË CURRAJ TE EPËR

Automobili kjo e mrekulli të mendjes njerëzore që ndryshoj botën si me magji shkeli për herë të parë të në tokë e begatë të Currajve të Epër me, 14 gusht 2018 fiks në 359 vjetorin e ditëlindjes së vet. Si vegim mrekulli bërës një tufë prej disa qindra automjeteve të markave nga më preferuar e që lundrojnë në karrexhatën shqiptare si neper ëndrra fluturuar nga Vrana e madhe dhe zbarkuan në Amfiteatrin e gjigand të Currajve. Livadhi i Kishës qindra vjeçare u hapi portën pash

më pash duke u uruar mirëseardhjen në qilimin e blertë dhe dhënë bekimin e shumë dëshiruar. Ishte një ditë historike nuk gaboj po them më e veçanta në historinë e kësaj zone! Zbarkimi i spektakolarë gjithë asaj autokolone “kozmonautesh” në “Hënën e ndaluar” u prit me gëzimi mbarë popullor. Në gojën e çdo banori të këtushëm buronte urimi: - E Gëzofshim Rrugën! Gëzimi i kësaj feste ushtoj si jehonë bjeshke dhe si refren përbashkues për gjakun e shpërndarë të këtij fisi në gjithë hapësirat shqiptare në Evropë Amerikë dhe Austarli. Që nga dita e parë që krijoi Zoti këtë kryevepër natyrore, nuk pati miq, vizitor dhe dashamirë sa me 14 tetor 2018 të ku bujarisht u festua ardhja e automobilin të parë. Gëzuan gjithë të gjallët! duke thanë lamtumirë izolimit gjeografik të stërzgatur Gëzuan të gjithë të vdekurit e shumë munduar, e kopatur ngabarrëterëndatë shpinës: Më në fund u realizua ëndrra e tyre e vradë dhe e marrë peng nga pa përgjegjshmëria dhe mediokriteti i shtetit shqiptarë. Varret e mbuluara nga fieri dhe ferrat thanë uratë;- E bekuar qoftë kjo ditë që po na çliron prej tmerrit të harresës. Kullave të moçme u erdhi fryma, u zgjuan nga agonia trishtues dhe bzanë njëra-tjetrës;- Të lumet ne po na kthehet robnia! Gëzuan dallëndyshet shtegtare të cilat do kthen se shpejtë në foletë tyre të

braktisura për t'i ndërtuar të reja me të bukura seç i kishin dje. Arat e mbuluara përdhunisht nga djerrit shpresojnë se do ju kthehet bujku i arratisur. Livadheve të Pikut dhe rudinave u qeshi fytyra, jazës së tyre ndoshta i erdhi fundi. Ata shpresojnë se kjo ditë e bardhë do rikthejë dashurinë e bjerrun tufat dhe çobanët më cilat krenoheshin këto bjeshkë. Këto kullota të pa stane, pa dele, dhi, lope që e shtri janë njësoi si djepi i thatë pa fëmijë. Trëvesa karshi oxhakut gjithë hare bujarisht uron:- Mirë se u pruni zoni në Cuaraj të epër. Ardhshi të bardhe miq, bija, dasmorë, festarë, turistë, natyralistë alpinist dhe sportist të aventurës!

Punimet për ndërtimin e kësaj rruge, në kushte të vështira të terrenit malor, por me optimizëm filluan më 4 korrik 2018. Muri i izolues mijëra vjeçar u përkthua në fund verën e vitit 2018. Ëndrra e vjetër më në fund u bë zhgjander se pari falë kontributit bujarë të bijve të këtij fshati në diasporë, bijve të këtij fshati biznesmen, të bijve të këtij fshati me zemër të madhe e koordinuar më së miri me mbështetjen e Pushtetit Vendor e Kryetarit të Bashkisë, Besnik Dushaj; Deputet Isuf Çelaj dhe administratorit të Njësisë së krahinës Nikaj-Mërtur, Gjovallin Gjeloashaj, por edhe të Shoqatës Nikaj-Mëartur, me kryetar Dr.Mhill Gecaj. Perdja e hekurt u ça Curaj ju bashkëngjit

hartës së rrugëve automobilistike të shteti Shqiptare që për mbi 100 vjet e kishte lënë jashtë gardhit infrastrukture. Curraj eper vetëzbuloj virgjërinë dhe hirit e veta si një mister starë i Alpeve tona reflektuar. Rruga solli gëzim si fëmija i parë në familje. Kjo foshnje do, përkushtim, dashuri, dhe zgjuarsia për rritur, ruajtur e mirë mbajtur. Asaj akoma i mungojnë kanalet, muret dhe pendët mbrojtëse nga erozioni. Reshjet e stuhishme ngrica dhe akulli do të ushtrojnë ndikimin e vet, por një gjë është e sigurt ajo rrugë nuk mund të bllokohet më kurrë. Nuk dëshiroj as nuk duhet të mbete thjeshtë një rrugë pyjore, por që brenda verës së ardhshme të plotësohet me të gjithë parametrat e një rruge turistike. Nëse ky drum i ri behet transit i vikingëve pushtues të mjedisit siç ka ndodhur gjatë këtyre tre dekadave anë këndë Shqipërisë, atëherë kreshtat u përkulshin dhe varroshin çdo barbare. Kjo rrugë e re në ditën pare promovuese mori bekimin Ipeshkvi i Sapës, Imzot Simon Kulli, ndërsa Presidenti i republikës Ilir Meta e quajti rrugën e ndryshimit të Curraj të Epërm e Nikaj-Mërtur. Menjëherë Curaj Eper duhet të marrë statusin e zonave të mbrojtur, për ndrysh kjo rrugë mund rezultojë shamisë e pamëshirshme për ashtat (pyjet) e begata. Mundë rezultojë vrase për troftën e bekuar pikaloshë që noton e lumtur në drejtim të kundër të rrjedhës së lumit kristalin të Cuarajve. Në se kjo zonë nuk ruhet nën masa të forta sigurie të një zone të mbrojtur. Kjo rrugë mund rezultojë një shytë rufeje për dhitë e egra në dhe drenushet që vallëzojnë në rripe. Kjo rrugë nuk duhet të kthehet në tranzit beton armeje, eterniti dhe llamarinë për shëmtuar traditën e vjetër të banesës tipike të zonës. Nëse këto gjera ndodhin atëherë bekimi i kësaj rruge të dëshiruar si drita do kthehet në mallkim!

Prelë Milani

## NJË KURORË, ME FJALË DHIMBJEJE DHE RESPEKTI!



Një lajm i rëndë erdhi këtë fundjavë nga Amerika e largët! U nda nga kjo jetë një burrë i nderuar i Xhanit dhe i Dukagjinit, DEDE GJON SHTËPIJA!

Ngushëllimet e sinqerta familjarëve dhe të afërmeve të tij ..Krishti e paste në Parajsë atë burrë të nderuar dhe zemërmirë. Unë e humba një mik të babës dhe timin, Dukagjini humbi njërin nga themeluesit e lëvizjeve kulturorë, poeti lirik, so-

cial dhe satirik, Profesori që mbaroj Universitetin e "Burrnisë dhe të mençurisë së maleve". Organizatori kryesor i grupeve artistike kulturorë për shumë vite në krahinën e Pultit dhe në zonën e Dukagjinit ...

Fjala e tij e ëmbël, mendimi i zgjuar, humori i hollë, aftësitë organizative dhe inteligjenca e lindur e kanë bërë që për 50 vite të jetë njëri ndër burrat më të dashur dhe të respektuar të kohës. Bujar dhe plote “prodhimtar”, në shtëpi, në rrugë, në kafe dhe në punë.

Njerëzit më të shkolluar, që punuan apo jetuan në atë krahinë dhe në atë zonë patën kënaqësi të shkojnë mik në shtëpinë e Ded Gjonit. Secili kishte çfarë të mësojnë nga mençuria dhe zgjuarsia popullore, që Zoti kishte mishëruar tek ai njeri.

Për shumë vite, në detyrën e punonjësit të kulturës dha një kontribut të veçantë në këtë fushë. Me qindra vargje të tij u bënë këngë, me mijëra vargje të tij u interpretuan nëpër koncerte e skena festivalesh në Pult, në Breglumit, në Shkodër,

në Tiranë dhe në festivalet e Gjirokastrës.

Kam pasur fatin ta njoh nga afër, ta dëgjoj, të rri me te dhe të mësoj prej tij.

Vitet e demokracisë e gjetën të plakur, por me shëndet të mirë e me plot humor. Nga vargjet dhe rapsoditë e tij mundi ti bashkoj në dy libra, që të mbeten si thesar ndër breza. Një burrë aq i ditur, aq i zgjuar dhe aq largpamës, me bindje mundëm me thanë, se kishte lindur në kohën e gabuar dhe në vendin e gabuar, por nëse sistemet i dënojnë njerëzit, Zoti i jep secilit atë që meriton.

DEDE GJON SHTËPIJA, kishte një bashkëshorte të mrekullueshme, me të cilën rriti dhe edukoi fëmijë të denjë për ta bërë atë të ndihet krenar dhe i nderuar.

Nëse familjes, të afërmeve dhe miqve do të na mungojë Deda, Dukagjinit, Shkodrës dhe mjekësisë i ka munguar dhe do ti mungojnë njeri nga mjekët më të mirë që ka nxjerrë toka Shqiptare, mjeku Ndoc Shtëpia, djali i madh i Dedës ...

Amerika, Toka e premtuar, vatra e tru-



rit intelektual të botës e ka ftuar atë që në vitet 90'. Atje në New York, së bashku me bashkëshorten Lena, pranë djemve, vajzave, nipërve dhe mbesave i kaloj vitet e fundit të jetës, miku im i mirë, poeti, artisti dhe burri i nderuar Dedë Gjon Shtëpia.

Nuk ka njeri që e ka njohur, të cilin nuk e kujton me respekt dhe dhimbje.

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në konferencën shkencore “100 vjet Arsim dhe kulturë në Dukagjin”, e ka vlerësuar dhe e ka nderuar për kontributin e tij ndër vite, me titullin “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin”.

Pak reshtha, që shkrova në këto momente dhimbje dhe respekti, le të jenë si një kurorë me lule mbi varrin e tij!

Zoti i forcoftë familjarët dhe të afërmit! Krishti të paste në parajsë miku, kolegu im, Dedë Gjon!

Dede Gjon Shtëpia, i lehte të qofte dheu!

Me respekt, **Lulash Brigja**

poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi

Nga NDUE MICI

**NËNA**

Nënë,  
Ti je ma e bukura fjalë  
Që nga goja e njeriut  
Mundet me dalë!

Ti lind jetën  
Ti lind njerinë;  
Ti thue të vërtetën  
Ti ndrit shtëpinë!

Ti rrit fëmijët  
I edukon drejt së mirës  
Se fëmija asht' ma e shtrenjta  
Krijesë e natyrës.

Atje nalt në qiell  
Ti ndrit si diell  
Si yll e si hanë  
Ndrit botën të tanë!

**FËMIJA DHE BORA E BARDHË**

Bora bie ngeshëm  
e zbardh ndër oborre  
Fëmijët nisin lojën  
me toptha prej bore

Lulet në saksi  
Vyshkur e zbardhë  
Tkurrur prej të ftohtit  
Nga bora e bardhë!

Stinë e dimrit ikën  
Bora avullon  
Lulja në saksi  
Nis e lulëzon

Fëmijët mblidhen tok  
S'ka ma toptha bore  
Nisin gjithë hare  
Vallen pranverore.

**LUKSOKRACIA!**

Në luks jetojmë  
Në luks harxhojmë  
Me luksin çdo ditë  
Lozim, harbojmë

Me luks mirëfilli  
Shkojmë në punë  
Luksi na shtohet  
Kur rrijmë pa punë

Punë apo pushim  
Në hamë e pimë...  
Në mungoftë ushqimi  
Hamë "luksokracinë"!

Nga LULASH BRIGJA

**PUTHJE POETIKE**

Diellit ia putha rrezet e para

Natës ia putha yjet e fundit  
Borën e puthja pa rënë në tokë

Shpesh i kam puthur valët e lumit  
Marsit ia putha dy manushaqe  
Njomëzën kur del e puthi me sy  
Dikur vrapoja të kapi flutura  
Herë puthja një e hënë puthja dy

Mrizat e bjeshkës dhe krojet e borës  
Duke i puthur s'u lodha kurrë  
Se bukurinë e kërkon syri  
Kur t' jesh i ri e kur të jesh burrë

Të dehesh me puthje është mrekulli...!  
E zura Hënë një natë në liqen  
Thonë se puthja të fal magji  
Mollët e kuqe puthja në gem

Punën e mirë e putha me sy  
dhe shpirtit tim i dhashë qetësi  
Se puthja, është themeli i jetës  
Aty ka lindur çdo dashuri

Duke lyp mjaltin më puthi bleta..?  
Me shpirt ja putha zërin bilbilit...  
Shpesh në gjemba i shpova gishtat  
Duke puth fletët e trëndafil

Sa herë kam puthur as vetë se di  
Më shumë në ëndërr sesa i zgjuar...  
Se bukurinë e ka fal Zoti  
Nëse ne dimë për ta shijuar

Nëse e putha një sy të bukur  
Që bëra mëkat askush mos t' thotë  
Sepse një puthja keq poetike  
Mëkat se quan askush në botë!

**ZANA E KËTIJ DIMRI...?**

Ah moj Zanë e këtij dimri  
emrin tënd nuk ma tha libri  
Ti që erdhe krejt papritur  
kaq të egër s'të kam ditur.

Si ky dimër kurrë s'kam parë  
ngrihet puthja si ujëvare  
koha akull, ti je prush  
sekretin se di askush!

Bora t' shkrihet përmbi qerpik  
Erë, acar e ti nuk ik,  
fjala jote akull të ngrihet  
kur buzëqesh fillon e shkrihet.

Kush ta dha adresën ty,  
që na vret me ata sy.  
Ti moj Zanë që vjen nga larg,  
na ke zënë si zog në çark

Ah moj Zanë e këtij janari,  
disa vargje po ti fali.  
Me atë zjarr që në shpirt ke,  
e shkrin borën përmbi re.

Ah moj Zanë moj zemërmire,  
për të varfrit të keni mëshire,  
mbushe botën me dashuri  
shkrije borën, bëje shi.

**GATI HARROVA!?**

Dimër i keq.  
Një sfond krejt gri.  
Festa pa shije, pa bukuri.

Ndërrohen vitet,  
s'ndryshon asgjë,  
As Viti i RI nuk buzëqesh më.

Fytyra të vrazhda,  
që blejnë mandarina,  
pak atmosfere, hiç kartolina.

Dimër i sertë,  
festa formale,  
Varfëri në fusha, skamje në male.

Me kafe e llafe,  
jetojnë shqiptarët,  
për punë të fundit, për fjalë të parët.

Të gjithë mashtrojnë,  
veten dhe të tjerët.  
- Bane Zot mirë se lumi po shteret!

Të bukura janë ëndrrat,  
pak shpresë ka mbetur.  
Këtu zogj të trembu, jashtë zogj të tretur

Po e mbush gotën,  
me vargjet që shkrova,  
t'ju them Gëzuar, se gati harrova!

**BURRAT E MALEVE**

Kullat e gurit në male,  
lëshojnë kushtrimin se vetëm kanë mbet.  
Ku janë... ku ikën burrat e zakonit,  
ku janë ata burrat e vërtet?

As fyell as çifteli nuk njihet.  
As zjarr në vatër . as tym në oxhak.  
Ku janë ata burrat fisnik të maleve?  
Me tirq, me xhamadan e me mustak!

Lahuta ka mbet e varur në mur.  
Livadhet e bjeshkës kurrkush si kosit.  
Krojet kanë nis me shter prej vetmisë.  
Edhe zogjtë e malit, me duket kanë ik.

Burrat i lëshuan kullat e malet.  
Rinia e lëshoj fushën e qytetin.  
Kurrkush s' po asht i kënaqur me kohën,  
veç ikun, ikun e mësyjnë kurbetin..

As turku. as shkjuar e as diktatura,  
s' na bane me i lëshua trojet e t' parëve.  
Burrat e maleve po lëshojnë kushtrimin  
Ktheju O Zot mendjen Shqiptareve.

Rinia ikun pa dit se ku shkojnë.  
Nuk din ku kanë trojet, as varret.  
Burrat e vjetër si lodh pleqëria.  
Por ngushtë jua bien mërzia e hallet.

Asht prish e asht vra qefti e dashnia  
Burrnia kurrkund s'po ka dyqan  
Ma i miri burrë i ka dal interesi  
Ai po banë zoteni gjithkënd.

Baba po më thotë me ndej me burra  
Koha më thotë me ndej me zoteni.  
Sa here që s'bije dakord me veten.  
Ja nis e shkruaj poezi...

**TRËNDAFIL**

Ti, o trëndafili që çel në pranverë,  
syrin e zemrës i bëre nder.  
Ti çel pas dimrit me akull e borë,  
dua të shoh të prek me dorë.

Ti, o trëndafili që çele në prill,  
lulja më e bukur, lulja më e mirë,  
vetëm të të preku petalet tua,  
shpirti po me ngopet tjetër nuk dua.

Në mars je gonxhe, në prill je lule.  
Ah, në dorën time erdhe u ule.  
Pa ty nuk shkruhen vargjet as kënga,  
një mijë petale edhe dy - tri gjemba.

Ti o trëndafil me ngjyrë dashurie,  
që ëndrrat e mija si le në hije.  
Kur jam pran teje përherë argëtohem,  
me ty buzëqeshi, me ty frymëzohem.

Unë ta di shijen ,unë ta di vlerën,  
aroma jote e rilind pranverën.  
Kur jam pran teje zemrës i bën nder.  
Ti të gjitha stinët i bën pranvere.

Fabula, nga NIKOLL DARDHA

Një qen soj qeni,  
me ca mish në gojë  
Përmidis një lumi  
deshi të kalojë

Në ujin e lumit,  
si të ish paqyrë  
I doli adashi,  
me të njëjtën fytyrë

Qenit tonë ju duk,  
se kish mish më shumë  
Ndaj nuk e zgjati,  
e u kredh në lumë

Por i gjori mbeti,  
fare pa mish  
Se ia mori vala,  
dhe atë që kish!

**REDAKSIA**

Kryeredaktore: Suela Ndoja  
Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,  
Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini,  
Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef  
Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin:  
**PRELË KROJ**

